

shkatërrimi ekologjik

Koha të veprojmë!

Raport Hije mbi Kapitullin 27
Kosova, 2022

Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike



KOALICIONI27



Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit rajonal "Zonat e Mbrojtura për Natyrën dhe Njerëzit II", zbatuar nga WWF Adria me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – Sida. Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë bosom janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Sida.



shkatërrimi ekologjik

Koha të veprojmë!

Raport Hije mbi Kapitullin 27
Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike

Shtator, 2022



KOALICIONI27

Përmbajtja

Hyrje	5
1. Ndotja e ujit	10
Pasqyrë e përgjithshme	10
Strategjia dhe plani	11
Legjislacioni dhe zbatimi	12
Problemet kryesore	15
Kapacitetet Institucionale	17
Rekomandime	19
2. Ndotja e Ajrit	22
Pasqyrë e përgjithshme	22
Strategjia dhe Plani	22
Legjislacioni dhe zbatimi	24
Problemet Kryesore	26
Kapacitetet Institucionale	29
Rekomandimet	31
3. Mbrojta e Natyrës	34
Pasqyrë e përgjithshme	34
Strategjia dhe Plani	38
Legjislacioni dhe zbatimi	40
Problemet Kryesore	43
Kapacitetet Institucionale	43
Rekomandimet	45

4. Pylltaria	48
Pasqyrë e përgjithshme	48
Strategjia dhe Zbatimi	49
Legjislacioni dhe zbatimi	49
Problemet kryesore	50
Kapacitetet institucionale	51
Rekomandimet	53
5. Ndryshimet Klimatike	56
Pasqyrë e përgjithshme	56
Strategjia dhe Zbatimi	57
Legjislacioni dhe zbatimi	58
Problemet kryesore	61
Kapacitetet institucionale	62
Rekomandimet	63

Hyrje

Ky raport pasqyron gjendjen e mjedisit në Kosovë dhe mbulon pesë tematika kryesore, duke përfshirë Ndotjen e Ujit, Ndotjen e Ajrit, Mbrojtjen e Natyrës, Mbrojtjen e Pyjeve dhe Ndryshimet Klimatike. Është raporti i pari i këtij lloji, dhe është përpiluar nga grupi i Joformal i organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e mjedisit, i emëruar si "Koalicioni 27".

Marrë parasysh rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, mirëqenien e qytetarëve dhe kriteret për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, Koalicioni 27 do të mund të luajë rolin e një mekanizmi avokues që përshpejton plotësimin e kriterëve të BE-së për mbrojtjen e mjedisit.

Meqenëse Kosova aspiron anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian dhe është nënshkruese e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Marrëveshjes së Gjelbër, ajo do të duhej të merrte përsipër edhe obligimet që dalin nga këto marrëveshje. Këto kriterë kanë të bëjnë kryesisht me reforma dhe përafrim të legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian dhe ndërmarrjen e masave për të ngritur kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se mbrojtja e mjedisit nuk ka qenë prioritet i asnjërës prej Qeverive dhe se ka shumë sfida dhe ngecje serioze në secilën fushë. Si rezultat i mungesës së vullnetit politik, zhvillimit pa kriter të infrastrukturës, ndërtimeve pa leje, mungesës së sundimit të ligjit dhe korrupsionit, Kosova sot ballafaqohet me një mjedis të degraduar me pasoja gati të pariparueshme mjedisore. Gjithashtu, në qoftë se analizohen kriteret e BE-së për mbrojtjen e mjedisit, atëherë mund të theksohet se vendi ynë është ende shumë larg plotësimit të këtyre kriterëve. Kjo situatë vjen si rezultat i mungesës së miratimit të disa ligjeve dhe zbatimit të tyre, mungesës së investimeve, si dhe kapaciteteve të mangëta të institucioneve për t'i adresuar këto sfida.

Duke e ditur se mbrojtjes së mjedisit i është kushtuar fare pak hapësirë edhe në raportin e progresit të Komisionit Evropian, atëherë ky raport do të mund të kontribuojë tek institucionet vendore dhe ndërkombëtare për të pasqyruar gjendjen reale dhe masat që duhen ndërmarrë në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Raporti analizon gjendjen e përgjithshme për secilën temë, legjislacionin dhe zbatimin e tij, strategjitë dhe planet, problemet kryesore, kapacitetin institucional dhe në fund jep disa rekomandime për të adresuar problematikat. Ndërkaq, periudha e hulumtimit dhe përgatitjes së raportit ka zgjatur nga muaji prill deri në qershor 2022.

Në anën tjetër, përpos sfidave të lartpërmendura, është inkurajues fakti që shohim aktivizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve të Kosovës, të cilët çdo ditë e më tepër janë më të zëshëm dhe shumë më kërkues ndaj Qeverisë për adresimin e problemeve që lidhen me mjedisin.

Ndotja e Ujit - Kosova nuk ka resurse të mjaftueshme ujore, gjë që mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm të saj. Në kapitullin për ndotjen e ujit përshkruhet gjendja aktuale e resurseve ujore dhe ujit në përgjithësi në Kosovë, duke u fokusuar te shkaktarët kryesorë të ndotjes së ujit në Kosovë dhe dëmet që janë shkaktuar. Ka mungesë të mbrojtjes adekuate të liqeneve artificiale, gjë që duhet të përmirësohet. Lumenjtë e Kosovës nuk janë të mbrojtur dhe janë në një gjendje të mjerueshme për shkak të ndotjes. Kjo ndotje shkaktohet kryesisht nga derdhja e ujërave të zeza dhe mungesa e impianteve të trajtimit, si dhe mbeturinat industriale dhe ato të ngurta. Përpos këtyre, ndërtimi i hidrocentraleve pa kriter ka shkaktuar humbje të sasive të ujërave dhe dëmtime të florës dhe faunës. Meqenëse gjendja faktike tregon se ujërat e Kosovës janë në situatë të rëndë, ka nevojë për mobilizim dhe intervenim të shpejtë institucional për t'i mbrojtur ato.

Ndotja e Ajrit - Si një vend që akoma është duke kaluar në fazën e zhvillimit ekonomik dhe me industri minimale, Kosova vuan nga ndotja enorme e ajrit. Vlerat e ndotjes së ajrit në vend gjatë periudhës së dimrit kur rritet konsumi i energjisë elektrike për ngrohje, tejkalojnë në masë të madhe vlerat e lejuara dhe paraqesin një problem shëndetësor për qytetarët. Varësia nga lëndë djegëse fosile e sektorit të energjisë dhe transportit në Kosovë kontribuon në këtë problem të shoqërisë tonë. Qeveritë njëra pas tjetrës nuk e kanë priorizuar këtë çështje dhe rrjedhimisht kanë ndërmarrë hapa të ngadalshëm ose nuk kanë ndërmarrë hapa fare për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Edhe pse rritja e investimeve në burime të ripërtërishme të energjisë, masat e efijencës së energjisë, rehabilitimi i termocentraleve dhe vendosja e filtrave, janë disa tregues pozitivë që do ta zbusnin sado pak situatën, mungesa e një strategjie të qartë për energji na lë të kuptojmë se Kosova do të vuajë edhe për një kohë të gjatë nga ndotja e ajrit.

Mbrojta e Natyrës - Kosova ka biodiversitet mjaft të pasur, me një llojllojshmëri të mirë floristike, vegjetative dhe faunistike. Edhe pse ligjërisht ka të shpallur një sipërfaqe të madhe të zonave të mbrojtura (11.53% e territorit të saj), klasifikimi i tyre është pjesërisht në harmoni me Unionin Botëror për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Mbrojtja e këtyre zonave dhe pasurisë llojore të organizmave të gjallë që jetojnë aty, mbetet ende sfiduese. Disa prej faktorëve kryesorë që rrezikojnë mbrojtjen e këtyre zonave janë mungesa e vullnetit politik, mungesa e kapaciteteve profesionale nga ana e institucioneve, mungesa e zbatimit të ligjit, mungesa e programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit, përdorimi i burimeve biologjike (prerja dhe vjelja e pyjeve), ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (aktivitetet rekreative), modifikimet e sistemeve natyrore, digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit, eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri dhe bujqësi), ndotja (ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, kanalizimet) dhe ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Pylltaria - Sipërfaqja pyjore në Kosovë është rreth 481 000 ha (44.7% e sipërfaqes totale)¹, çka konsiderohet si e qëndrueshme. Edhe pse në bazë të ligjit pyjet konsiderohen si pasuri kombëtare me rol të rëndësishëm jetësor, në praktikë ato nuk po konsiderohen të tilla, ku si rezultat kemi dëmtime enorme. Përkundër faktit që Kosova ka kohë që ka filluar të hartojë strategji, ligje dhe plane menaxhuese për pyjet, faktet në terren na tregojnë se situata është brengosëse. Disa prej problemeve kryesore të këtij sektori janë prerjet ilegale, mungesa e kapaciteteve institucionale për t'i mbrojtur pyjet, mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit mes institucioneve përgjegjëse, zbatimi i pamjaftueshëm i akteve ligjore dhe nënligjore, strategjive dhe programeve, investimet e pamjaftueshme dhe jo prioritare për sektorin e pylltarisë, si dhe mungesa e shkollës së mesme profesionale. Edhe pse në universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit ekziston programi për Shkencat e pyjeve dhe mjedisit, në nivel bachelor, ende nuk ka të dhëna për bashkëpunim mes Agjencisë Pyjore dhe këtij fakulteti për profilin e kuadrove të nevojshëm në këtë fushë Pra, pa një qasje serioze nga ana institucionale, do të jetë e pamundur të adresohen problematikat në këtë sektor.

Ndryshimet klimatike - Gjersa Bashkimi Evropian shfaqet ambicioz dhe synon që t'i ulë deri në 55% emetimet e gazrave serë deri në vitin 2030, Kosova duket se është në fillimin e rrugës dhe shumë larg arritjes së këtyre objektivave. Një prej faktorëve kryesorë që shkaktojnë emetime të gazrave serë në Kosovë është prodhimi i energjisë përmes thëngjillit dhe termocentraleve të stërvjetruara (86%), dhe që pasohet nga sektori bujqësisë, pylltarisë, mbeturinat dhe proceset e tjera industriale. Për më tepër, rruga për të arritur caqet e përcaktuara nga Bashkimi Evropian, duket shumë sfiduese për një shtet të cilit i mungojnë kapacitetet institucionale, strategjia për energjinë dhe ligji për ndryshimet klimatike. Mungesa e kapaciteteve institucionale dhe mosmiratimi i këtyre dy dokumenteve strategjike, e lë Kosovën në situatë të mjegullt, ngase ende nuk është e qartë nëse Kosova do të jetë e gatshme që përfundimisht të heqë dorë nga përdorimi i thëngjillit, apo në një skenar tjetër, cilat do të ishin alternativat për të diversifikuar burimet e saj të energjisë.

Duke qenë të vetëdijshëm që Kosova ballafaqohet me shumë probleme mjedisore dhe zgjidhja e tyre kërkon kohë dhe kosto financiare, Koalicioni 27 dëshiron që të alarmojë institucionet qeveritare se duhet të veprohet menjëherë me hapa konkretë drejt përmirësimit të gjendjes mjedisore, duke marrë vendime për uljen e emetimeve të gazrave serë, përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, kufizimin ose ndalimin e plotë të përdorimit të qeseve plastike, mbrojtjen rigorozë të akumulacioneve që shfrytëzohen për ujë të pijshëm, si dhe për menaxhimin e ndryshimeve klimatike. Të gjitha këto veprime, pa asnjë dyshim, do të ndikojnë në përmirësimin e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës, e cila heshtazi i bart pasojat e ndotjes mjedisore.

¹ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/84090_Inventarizimi-Nacional-i-Pyjeve-Kosov%EB-2012_WEB.pdf

Për Koalicionin

VIZIONI

Republika e Kosovës duhet të ketë një mjedis të ruajtur i cili është në shërbim të mirëqenies së njerëzve dhe natyrës, një ekonomi të zhvilluar dhe me karbon të ulët, e cila shkon drejt neutralitetit, me përdorim eficient dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

MISIONI

Koalicioni 27 do të monitorojë dhe kontribuojë në procesin e harmonizimit dhe zbatimit të politikave dhe rregullave të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së për fushën e mjedisit dhe ndryshimet klimatike.

ROLI

Koalicioni 27 do të avokojë dhe do të bëhet kujdestar në procesin e përfshirjes së publikut në negociatat e anëtarësimit të Kosovës me Bashkimin Evropian, me qëllim të propozimit të zgjidhjeve të përshtatshme të mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të kualitetit të jetës për qytetarët.

ORGANIZATAT KONTRIBUUESE:

1. Ndotja e Ujit - GLPS
2. Ndotja e Ajrit - INDEP
3. Mbrojtja e Natyrës - Qytetarët Aktivë
4. Pylltaria - CNVP
5. Ndryshimet Klimatike - WWF Adria



KOALICIONI27



ndotia e ujit

Foto: Yllka Fetahaj



1. Ndotja e ujit

Pasqyrë e përgjithshme

Territori i Kosovës, në aspektin hidrografik, është i pasur me ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, me lumenj të ndryshëm dhe akumulacione artificiale apo natyrore.² Pëllgu ujëmbledhës topografik i Kosovës është 11,645 km², ndërsa akumulacionet ekzistuese janë 569,690,00 m². Në pëllgun e Drinit të Bardhë gjenden nëntë lumenj me prurjet më të mëdha brenda vitit. Në aspektin hidrografik, Kosova është e ndarë në 4 pëllgje lumore:

- Drini i Bardhë,
- Ibri,
- Morava e Binçës, dhe
- Lepenci.³

Lumenjtë e Kosovës derdhen në katër pëllgje ujëmbledhëse detare dhe këta lumenj largohen nga Kosova brenda 24 orëve nga burimi. Meqenëse këto burime ujore nuk qëndrojnë në Kosovë, është e vështirë të plotësohen nevojat e qytetarëve të Kosovës për ujë të pijshëm dhe për ujitje, peshkim, turizëm dhe prodhim të energjisë elektrike. Krahasuar me fqinjët e saj, Kosova konsiderohet të ketë mungesë të ujit në periudha të caktuara.⁴ Gjithashtu, Kosova ka nivelin më të ulët të burimeve ujore të zhvilluara me infrastrukturë. Në përgjithësi, Kosova është relativisht e mangët me ujë dhe ka reshje modeste të cilat përgjithësisht bien në dimër, dhe shumica në pjesën jugperëndimore.⁵

MMPH, në harmoni me Direktivën e Bashkimit Evropian për ujërat (EWFD, 2000) ka themeluar Autoritetin rajonal të pëllgjeve lumore (ARPL) si njësi e cila duhet të hartojë Planet menaxhuese të pëllgjeve lumore, në kuadër të të cilave duhet të parashihet edhe Programi monitorues i tyre si dhe masat për mbrojtje. Momentalisht është i hartuar Plani menaxhues për pëllgun e Drinit të Bardhë, kurse për planet e pëllgjeve të tjera lumore ARPL është duke në këtë drejtim me përkrahje nga projekti SKAT. Sidoqoftë, për realizimin e këtyre planeve në praktikë do të nevojitet kohë për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe laboratorike. Monitorimin e ujërave sipërfaqësore e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, i cili ka 54 pika të mostrimit.

Kosova ka një numër të vogël të liqeneve natyrore. Ka disa akumulacione sipërfaqësore ose të njohura ndryshe si Liqene Artificiale (Batllava, Ujmani, Radoniqi, Përlepnica dhe Badovci), si dhe një sërë liqenesh të vegjël për ujitje. Sipas master planit për ujërat (1983), në territorin

2 Raport për gjendjen e ujërave në Kosovë, 2020, Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB.pdf

3 Informata të mbledhura nga Sistemi Informativ Ujor, qasur për herë të fundit në maj 2022, <https://siu.rks-gov.net/Hydrography/Surfacewaters>

4 Perspektiva e sigurisë së ujit në Kosovë, Banka Botërore, <https://documents1.worldbank.org/curated/en/496071548849630510/water-Security-Outlook-for-Kosovo.pdf>

5 Po aty.

e Kosovës ishin planifikuar të ndërtohen edhe njëzet akumulacione ujore sipërfaqësore si dhe një numër mikro-akumulacionesh.⁶

Në vitin 2021, përafërsisht 96.88% e popullsisë së Kosovës furnizohej me ujë përmes sistemit publik të menaxhuar nga Ujësjiellësit Rajonalë, ndërsa 3.16% nuk kishin qasje në shërbimin e furnizimit me ujë publik.⁷ Megjithatë, me kalimin e viteve ka pasur një numër në rritje të qytetarëve që kanë qasje në ujësjiellësin publik.

Lumenjtë në Kosovë janë të ndotur, posaçërisht rrjedhat e mesme rreth vendbanimeve nuk janë në gjendje të mirë dhe janë të stërngarkuara me ndotës të natyrave të ndryshme dhe pa një mbrojtje efektive institucionale. Fatkeqësisht, në lumenj hidhen mbetje inerte, shkarkime të ujërave të zeza nga amvisëritë dhe nga objektet industriale, kështu që lumenjtë shndërrohen në kolektorë apo mbledhës të ujërave të zeza.

Deri më tani në Kosovë ekziston vetëm një impiant që trajton ujërat e ndotura urbane, i cili është në Skënderaj. Shkarkimi i ujërave të zeza bëhet drejtpërdrejt në lumenj, prandaj kjo përfaqëson një nga faktorët kryesorë të ndotjes së ujërave sipërfaqësore.⁸ Në vitin 2021 janë ndërtuar edhe tre impiante të tjera për ujërat e zeza në Prizren, Gjakovë dhe Pejë. Këto impiante për ujërat e zeza tani janë në fazën e testimit.

Lidhur me ndotjen e ujit, BE-ja vazhdimisht i rekomandon Kosovës, ndër të tjera:

- Krijimin e një sistemi efektiv për monitorim të ujërave, publikimin e të dhënave dhe ndërmarrjen e masave urgjente dhe të përhershme për reduktimin e ndotjes së ujit;
- Zbatimin e dispozitave ligjore për përgjegjësinë mjedisore, dëmin dhe krimin; zbatimin e parimit ndotësi paguan, dhe krijimin dhe fillimin e një fushate të përhershme për vetëdijësimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit.⁹

Strategjia dhe plani

Sipas Raportit të BE-së për Kosovën 2021, Kosova ka demonstruar progres në përafrimin e legjislacionit për ujërat me acquis të BE-së. Aty përmendet se Kosova ka një Strategji për Ujërat 2017-2036, por niveli i përafrimit me acquis të BE-së mbetet shumë i ulët dhe mekanizmi monitorues nuk është i mjaftueshëm. Për më tepër, raporti rekomandon fuqizimin domethënës të zbatimit të Ligjit për Ujërat. Raporti shprehet se "Ngritja e një këshilli ndërministror për ujërat pranë ZKM-së është një hap pozitiv."¹⁰ Gjithashtu, raporti shprehet se rrjetet e monitorimit të burimeve ujore janë ende të paplota, veçanërisht për ujërat nëntokësore.

Kuvendi i Kosovës, më 4 prill 2021, miratoi planin e veprimit të Agjendës së Reformave Evropiane (ARE) II, ndërsa një nga aktivitetet e parapara është, zhvillimi i politikave për

6 Po aty.

7 Statistikat e Ujërave në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/media/6724/statistikat-e-ujrave-ne-kosove-2020-2021.pdf>

8 Po aty.

9 Raporti për Kosovën 2021, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

10 Po aty.

reduktimin e ndotjes së ujit dhe ajrit dhe përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe ekonomisë qarkore. Si tregues është hartimi i planit të veprimit 2022-2024 për zbatimin e Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë (2017-2036). Mirëpo, kjo strategji e përmendur nuk është e publikuar në faqet zyrtare të Kuvendit, Zyrës së Kryeministrit dhe MMPHI-së. Kjo Strategji nuk është publikuar në platformën e konsultimit publik, që do të thotë se nuk ka pasur konsultime të duhura siç parashihet me legjislacionin, konkretisht me Rregulloren (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

Ligji për Ujërat përcakton rregullin që Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë të hartohet nga MMPHI për një periudhë 20 vjeçare me mundësi rishikimi çdo pesë vjet dhe Strategjia të miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, Strategjia në fuqi është hartuar nga Këshilli Ndërmintor për Ujërat dhe, me sa duket, jo në koordinim me institucionet e tjera. Prandaj, ky dokument nuk është i disponueshëm për publikun përmes burimeve zyrtare. Grupi hulumtues ka tentuar të marrë informacion nga Zyra e Kryeministrit, por deri më tani nuk ka pasur asnjë përgjigje.

Në tekstin e kësaj Strategjie thuhet se ky dokument është përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në koordinim me autoritetet përkatëse. Kjo strategji ishte planifikuar të rishikohej çdo 5 vjet.

Plani menaxhues për pellgun e Drinit të Bardhë është hartuar, por ende nuk ka filluar zbatimin e tij, e po ashtu së fundmi ka pasur një proces të konsultimit publik për Programin e Punës dhe kalendarin e aktiviteteve për përgatitjen e planeve menaxhuese për menaxhimin e pellgjeve lumore "Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc" për periudhën 2022-2028.

Ky plan është përgatitur me synimin për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të sistemeve ujore, duke nxitur përdorimin e ujit duke siguruar mbrojtje afatgjatë të burimeve ujore; për forcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke marrë masa specifike për reduktimin progresiv të ndotjes që lidhet me shkarkimet dhe ndotjet e tjera, për të kontribuar në uljen e pasojave të vërshimeve dhe thatësirave, për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore me cilësi të mirë.¹¹ Në këtë dokument thuhet se pellgjet lumore në Kosovë u nënshtrohen treguesve të ndryshëm të jashtëm, si shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujërave të zeza dhe të patrajtuara nga amvisëritë, bizneset e ndryshme industriale, ndotja nga bujqësia dhe deponimi i mbeturinave. Prandaj nevojitet konsultim me palët e interesit, veçanërisht për identifikimin e çështjeve kyçe, për të vendosur objektivat, prioritetet, etj.

Duhet cekur se monitorimi i ujërave, publikimi i të dhënave për gjendjen e tyre, caktimi i masave ndëshkuese për shkaktarët e krimeve mjedisore në ekosistemet ujore, si dhe marrja e masave për reduktimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mbeten si kërkesa të vazhdueshme në Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën¹⁶.

¹¹ <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/16-27-13-27042022/Publikim-i-programit-te-punes-dhe-kalendarit-i-aktiviteteve-per-pergatitjen-e-Planeve-per-Menaxhim-te-Pellgjeve-Lumore.pdf>

Legjislacioni dhe zbatimi

Shumica e akteve ligjore të Kosovës për ujërat janë të harmonizuara me Direktivën e Bashkimit Evropian për ujërat (DKU 2000/60EC), dhe një seri të Direktivave të tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe mbrojtjen e ujërave. Megjithatë, duhet fuqizim institucional për zbatimin e tyre në masë të gjerë.

Në Kosovë, pasuritë natyrore si uji, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gëzojnë mbrojtje të veçantë në përputhje me ligjin.¹² Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ujërat) në fuqi që nga viti 2013, është ligj i veçantë që ofron mbrojtje të ujërave dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore duhet të jenë në përputhje me këtë ligj. Qëllimi kryesor i këtij ligji është sigurimi i zhvillimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, vendosja e procedurave për shpërndarjen optimale të burimeve ujore, sigurimi i mbrojtjes së burimeve ujore nga ndotja, mbipërdorimi dhe keqpërdorimi, si dhe përcaktimi i strukturave institucionale për menaxhimin e burimeve ujore.¹³

Ligji aktual për Ujërat është duke u rishikuar, dhe me Programin Legjislativ për vitin 2022 është paraparë që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat të miratohet në Qeverinë e Kosovës në qershor të vitit 2022.¹⁴ Megjithatë, ky projektligj nuk ka qenë ende në proces konsultimesh dhe është publikuar vetëm një version që ka qenë në konsultime publike nga data 13.11.2020 deri më 04.12.2020. Kjo do të thotë se mund të ketë një vonesë në afatin e propozuar.

Ka shumë akte nënligjore që dalin nga Ligji për Ujërat për ta rregulluar më tej çështjen e mbrojtjes së ujërave. Megjithatë, kjo mund të jetë edhe pengesë gjatë zbatimit, sepse zyrtarët publikë duhet të kenë parasysh një numër të madh dokumentesh.

Aktet nënligjore në fuqi janë si më poshtë:

- Udhëzimi Administrativ (QRK) – Nr. 06/2021 për strukturën e pagesave të ujit;
- Rregullorja (QRK) – Nr. 11/2014 për detyrën e Këshillit Ndërmintor për Ujërat;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) – Nr.03/2018 për procedurat për leje ujore;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 15/2017 për kriteret e përcaktimit të zonave mbrojtëse sanitare të resurseve ujore;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 16/2017 për klasifikimin e trupave ujqorë sipërfaqësorë;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 17/2017 për klasifikimin e trupave ujqorë nëntokësorë;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 09/2017 Udhëzimi për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e digave;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) – Nr. 05/2016 për rregullimin e statusit të pasurisë ujore;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 04 /2016 për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e brigjeve dhe akumulacioneve të rrjedhave ujore;

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 122, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

¹³ Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659>

¹⁴ Programi Legjislativ për vitin 2022, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/01/Programi-Legjislativ-per-vitin-2022.pdf>

- Rregullorja (MMPH) - Nr.02/2016 për mënyrën e përcaktimit të normave të pranueshme të prurjeve ekologjike.
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) - Nr. 12/2015 për përcaktimin e kriterëve për zonat e mbrojtura për qëllime strategjike;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) - Nr. 19/2015 për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujit;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) - Nr. 20/2015 për kriteret për zonat për larje;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2013 Sistemi Informativ Ujor;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 26/2013 për përcaktimin e mënyrës së verifikimit dhe legjitimitit të Inspektoratit të Ujërave.
- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufitare të derdhjes së ujërave të zeza në rrjetin publik të kanalizimit dhe në trupin ujor.

Ligji për Ujërat, ndër të tjera, rregullon qasjen në informata lidhur me ujërat, pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes lidhur me menaxhimin e ujërave, vlerësimin e ndikimit të strategjive, planeve dhe programeve të ndryshme në mjedis, vlerësimin e ndikimit të projekteve të caktuara, parandalimin dhe kontrollin e defekteve me prezencën e materialeve të rrezikshme, leje ekologjike të integruara për instalimet që ndikojnë në mjedisin ujor. Mirëpo, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejshëm: MMPHI), për shumë vite nuk ka mundur t'i zbatojë disa dispozita të këtij ligji në disa raste, p.sh. lejet për ndërtimin e hidrocentraleve janë dhënë në kundërshtim me ligjin pasi nuk kishte vlerësim të duhur të ndikimit dhe ishte mohuar pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes.

Ky ligj parasheh një dispozitë që zbatimi i masave të parapara me ligjin për ujërat të mos lejojë përkeqësimin e gjendjes së ujërave. Por, në të kaluarën, MMPHI nuk ka arritur të veprojë plotësisht në përputhje me këtë dispozitë dhe kjo ka sjellë degradimin e lumenjve.

Ligji për ujërat specifikon se ujërat nuk i nënshtrohen të drejtës së pronësisë së personave fizikë dhe juridikë, dhe neni 48 i ligjit parashikon një dispozitë që nuk lejon ndërtimin më afër se 30 metra nga vija e rrjedhave dhe akumulacioneve ujore. Megjithatë, për shembull, disa leje të dhëna (për shembull lejet për HEC-in Lumbardhi, Belaja, Sharri) lejuan ndërtimin e objekteve në afërsi të ujërave. Kurse Komuna e Shtërpçës ia ka dhënë ujin në shfrytëzim një kompanie private duke shkelur nenin 109 paragrafin 3 të Ligjit për Ujërat. Një çështje shqetësuese është se në Projektligjin për Ujërat të publikuar në platformën e konsultimit publik në vitin 2020, ndryshon neni 48, paragrafi 1.3 që ndalon: *"ndërtimin e ndërtesave dhe objekteve të tjera që nuk i shërbejnë mbrojtjes nga vërshimet dhe që pengojnë qasjen në rrjedhat e ujit në një distancë prej më pak se dhjetë (10) metra nga vija e arritjes së ujërave 100 vjeçare për të gjitha ujërat sipërfaqësore, përveç nëse pronari ose përdoruesi është kushtëzuar të ndërtojë objektin duke marrë masa paraprake për të parandaluar ose zvogëluar efektet e dëmshme nga uji".*¹⁵

¹⁵ Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40985>

Neni 60 i Ligjit për Ujërat rregullon çlirimin e ujërave të ndotura duke "ndaluar, përveç me leje ujore, shkarkimin e sasive të lëngshme të mbetjeve industriale, të ujërave të zeza bujqësore e urbane dhe të vajrave që përdoren në kanalizimet ose sistemet e kullimit në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në brigjet e lumit dhe të ligatinave".¹⁶ Më tej, ligji për ujërat përcakton që MMPHI do të vendosë për kushtet, metodat, parametrat dhe vlerat kufitare të ujërave të zeza të lëshuara me akt nënligjor. Ky akt nënligjor është miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe është nënshkruar nga ministri më 10.05.2022 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.¹⁷

Problemet kryesore

Problemi që mbetet është mungesa e zbatimit të dokumenteve ligjore dhe strategjike në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit të ujërave. Kjo vlen sidomos për dokumentin aktual strategjik - Strategjia për Ujërat, e cila është në fuqi që nga viti 2017, por që ende nuk ka një plan veprimi të hartuar dhe të miratuar.

Për më tepër, në këtë strategji është paraparë që Zbatimi i Strategjisë Shtetërore për Ujërat të realizohet nëpërmjet Planit të Veprimit dhe Investimeve për Ujërat (PVIU), i ndarë në katër pesëvjeçarë. Edhe pse pesëvjeçari i parë ka përfshirë periudhën 2017-2021, nuk ka ndonjë të dhënë se si është zbatuar ky plan, çka, fatkeqësisht, nënkupton se nuk ka zbatim të kësaj strategjie dhe nuk ka transparencë se si po zbatohet ky dokument. Zyra e Kryeministrit mbeti e heshtur lidhur me këtë çështje dhe nuk na dha informacion se pse nuk është publikuar ky dokument dhe si po zbatohet.

Problem tjetër është fakti se vitet e fundit është shkelur Ligji për Ujërat në rastet e ndërtimit të Hidrocentraleve (në tekstin e mëtejshëm HEC) në Kosovë. Ndërtimi i HEC-eve në Kosovë, duke mos respektuar ligjin, ka rezultuar me dëme dhe degradim të pariparueshëm të natyrës. Moskompetenca e institucioneve publike dhe mungesa e vullnetit politik për të ndaluar degradimin e mjedisit, rezultoi në vështirësimin e jetës së qytetarëve që jetojnë në rrethina, reagimet e të cilëve u shpërfillën nga institucionet qeveritare.

Fatkeqësisht, në Kosovë, jeta lumore aktualisht po përballet me rrisje për shkak të zhvillimit të shpejtë të hidrocentraleve. Lumenjtë e Ballkanit do të njihen si lumenjtë e fundit me rrjedhje të lirë në kontinentin evropian, andaj ofrojnë një vlerë të madhe ekologjike – konsiderohen zemra e kaltër e Evropës.¹⁸

Sipas analizës së bërë nga ekspertët e mjedisit, Kosova nuk ka burime të mjaftueshme ujore të cilat mund të ndihmojnë në zhvillimin e saj të qëndrueshëm. Ministria e Energjisë dhe Minierave në atë kohë (2006, 2009 dhe 2010) përmes studimeve paraprake të fizibilitetit

16 Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 60, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659>

17 Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 02/2022 për mënyrat, parametrat dhe vlerat kufitare të shkarkimit të ujërave të zeza në ujërat e zeza publike dhe në trupin ujor, <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=41&CatID=22&fbclid=IwAR30bKA-68xGDswMhbmUy5Jo5MaGcT5ea2QnddbY8sx-ekh96Bb1eneIRC4>

18 Lumenjtë e Ballkanit: Shpëtoni zemrën e kaltër të Evropës, <https://riverwatch.eu/en/balkanrivers/background>

identifikoi potencialin e ndërtimit të 79 HEC-eve në Kosovë, me një kapacitet total prej 34.4 Mw.¹⁹

Në vitin 2005 Kosova nënshkroi Traktatin e Komunitetit të Energjisë, dhe mori përgjegjësinë për të arritur një pjesë prej 25% të energjisë nga burimet e ripërtërishme në bruto konsumin final të energjisë deri në vitin 2020. Kjo u konfirmua me Ligjin nr. 05/L-081 për Energji. Fatkeqësisht, në përpjekjen për ta përmbushur këtë detyrim Ministria ka bërë shumë shkelje të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Pra, në dekadën e fundit, HEC-et në Kosovë janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin. Procesi i ndërtimit të këtyre HEC-eve të planifikuara është përcjellë me degradimin e lumenjve dhe me shumë shkelje të ligjit. Aktualisht janë tre padi që kontestojnë lejet për hidrocentralet në Deçan, HC Brezovica dhe HC Lepenci 3. Në këto tri raste gjykata ka vendosur që t'i pezullojë lejet e kontestuara deri në vendim të formës së prerë. Fatkeqësisht, këto vendime nuk po respektohen nga kompanitë dhe hidrocentralet vazhdojnë të funksionojnë.

Shkeljet kryesore ligjore të konstatuara për ndërtimin e HEC-eve (në përgjithësi) janë:

1. Moszbatimi i procedurës së koncesionit;
2. Mungesa e transparencës;
3. Nuk është parashikuar asnjë masë zbutëse reale;
4. Lejet e ndërtimit janë lëshuar disa herë nga Ministria, edhe pse kjo është dashur të bëhet nga komunat në disa raste;
5. Ndërtesat janë pranë lumit në kundërshtim me ligjin.
6. Në Zonat e Mbrojtura ka pasur shumë ndërtime si në Manastirin e Deçanit dhe Parkun e Mbrojtur Kombëtar Sharri.
7. Shumë hidrocentrale kanë nisur funksionimin pa pasur leje mjedisore, edhe pse kjo kërkohet me ligj.

Moszbatimi i procedurës së koncesionit është shkelje e zakonshme për të gjithë HEC-et që janë ndërtuar apo planifikuar të ndërtohen në Kosovë. Ligji për Ujërat e Kosovës përcakton rregullin dhe kushtet për dhënien e të drejtës ujore. Siç shpjegohet ka dy mënyra për të fituar të drejtën ujore, njëra me leje ujore dhe tjetra me koncesion. Më tej, nenet 72 dhe 78 të ligjit parashikojnë detaje mbi procedurën e marrjes së lejes ujore dhe gjithashtu përcaktojnë rregullin se kur nevojitet koncesioni. Ligji specifikon se koncesioni do të jepet nga Ministria dhe do të jepet, ndër të tjera, për përdorimin e energjisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike. Kjo shkelje konfirmohet edhe nga Raporti i Ministrisë, i cili rekomandon heqjen e lejeve të dhëna.²⁰

Mungesa e transparencës ka ndjekur të gjitha proceset e ndërtimit të HEC-eve, veçanërisht në tri çështjet që janë ngritur si raste gjyqësore. Në të tre rastet, nuk ka pasur një debat të duhur publik, që do të thotë se është shkelur e drejta kushtetuese e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje në lidhje me mjedisin ku jetojnë.

¹⁹ Arsyetimi i hidrocentraleve të vegjël në pellgun e lumit Lepenci dhe arsyet pse ato nuk duhet të ndërtohen, OJQ "Gjethi".

²⁰ Raport i Grupit të Punës për shqyrtimin e procedurave administrative të aplikuara për hidrocentralet dhe ndikimin në ujë dhe mjedis, [https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Final%20i%20Grupit%20Punues%20per%20Hidrocentralet-converted-2\(2\).pdf](https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Final%20i%20Grupit%20Punues%20per%20Hidrocentralet-converted-2(2).pdf)

Sipas ekspertëve të mjedisit, MMPHI i ka dhënë lejet ujore në kundërshtim me ligjin. Për shembull, në rastin e HEC-it në Deçan: a) nuk është treguar sa litra ujë do të përdoren, kështu që nuk ka pasur një studim të duhur të rrjedhës ekologjike, (ii) ka qenë e nevojshme të matet një minimum ekologjikisht i pranueshëm për rrjedhën e Lumbardhit të Deçanit, (iii) ky studim i rrjedhës si parakusht ekologjik është dashur të bëhet para dhënies së pëlqimit ujqor, është dashur të vërtetohet se lumi e ka sasinë e nevojshme për jetesë, florë dhe faunë, (iv) askund nuk përmendet si do të mbrohet trofta, e cila mbrohet gjithashtu nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, (v) meqenëse projekti është projektuar me bazën e magazinimit, marrja e lejes përpara se të fillojë baza e magazinimit është mashtruese dhe duhet të anulohet, (vi) ka erozion dhe degradim mjedisor aty ku duhej të ndërtohej pellgu akumulativ i njohur si "Zalli i Rupës", mosrehabilitimi i të cilit prek malësorët e fshatit Rashiq të Pejës, (vii) është futur një tub në burimet e ujit të pijshëm nga të cilët furnizohet Komuna e Deçanit, (ix) është vërtetuar mungesa e rehabilitimit të ujëmbledhësve, e cila ndikon në ujin e pijshëm për 30,000 banorë të Komunës së Deçanit, dhe (x) kur uji hyn në tubacione rrezikohet flora dhe fauna dhe brigjet e lumenjve.

Ende nuk ka asnjë nismë serioze për restaurimin e lumenjve nga asnjë prej kompanive që ndërtuan HEC-et, edhe pse ky është një detyrim ligjor. Kjo ka shkaktuar dëmtime serioze të mjedisit në ekosistemet e lumenjve dhe komunitetet lokale përreth.

Ekspluatimi i pakontrolluar i zhavorrit nga shtretërit e lumenjve është një dukuri e cila në masë të madhe po ndikon në degradimin e lumenjve dhe paraqet risk permanent për banorët e zonave rreth tyre, por edhe për vërshime. Si pasojë e mosveprimit të ligjit dhe inspektoratit, intensiteti i ekspluatimit të zhavorrit po shënon rritje nga viti në vit.

Një problem tjetër serioz në çështjet e ujit është se lumenjtë po ndotën nga ujërat e zeza dhe mbeturinat e tjera. Sipas raportit të Bankës Botërore, të gjitha pellgjet kryesore lumore të Kosovës janë të ndotura dhe raportohet se disa burime ujore ishin shumë të ndotura ose rrezikoheshin të kontaminoheshin si pasojë e mostrajtimit të ujërave të zeza, ujërave industriale dhe të termocentraleve, mungesa e mirëmbajtjes së sistemit të ujërave të zeza, shpyllëzimi intensiv ose bujqësia.²¹ Ka një rast në Prishtinë, në lagjen Mati 1, ku kanali i ujërave të zeza që derdhen në lumin Sitnica është i hapur. Kjo lagje është shumë e populluar dhe ka një numër të madh banorësh, gjithashtu ka dyqane ushqimore të ndryshme. Deri më tani kjo nuk është trajtuar nga institucionet përgjegjëse dhe ujërat e zeza vazhdojnë të rrjedhin hapur, gjë që paraqet risk të lartë për shëndetin publik.

Po ashtu, lumi Mirusha, në Komunën e Malishevës, është një shembull tjetër si lumi ndotet nga ujërat e zeza. Edhe pse ky resurs ujqor është shpallur nga Qeveria si zonë e veçantë natyrore, prapë nuk merr trajtimin e duhur. Në këtë lumë derdhen 11 rrjedha të ujërave të zeza nga fshatrat Bellanicë, Temeqinë, Bubël, Panorc, Rud, Turjakë, Mirushë, Lubizhdë, Banjë, Damanek dhe Llapqevë. Si rezultat i kësaj, më 2018 dhe 2019 ka pasur ngordhje masive misterioze të peshkut.

Uji i ndotur paraqet risk edhe për shëndetin e qytetarëve. Në vitin 2021, nga uji i pijshëm në Deçan janë helmuar rreth 1,500 persona. Rezultati i analizave të bëra të ujit të pijshëm në

²¹ Perspektiva e Sigurisë së Ujit në Kosovë, Qershor 2018/WAT, Grupi i Bankës Botërore, <https://documents1.worldbank.org/curated/en/496071548849630510/Water-Security-Outlook-for-Kosovo.pdf>

Deçan konfirmoi se ky ujë ishte i kontaminuar dhe kishte baktere si koliformi dhe escherichia coli. Lidhur me këtë rast janë ngritur akuza ndaj ujësjellësit dhe procesi është ende në vazhdim.

Kapacitetet Institucionale

Organet kryesore përgjegjëse për koordinimin, planifikimin, programimin, buxhetimin, financimin dhe monitorimin e çështjeve të ujit, përfshijnë Divizionin e Ujërave në kuadër të Departamentit të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Ujërave të MMPHI-së, Komunat, Këshillin Ndërmintor për Ujërat, Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore, Agjensionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit, dhe Institutin e Kosovës për Ujëra.

MMPHI-ja ka përgjegjësitë kryesore për zbatimin e legjislacionit mjedisor, por edhe ministritë e tjera kanë përgjegjësi të ngjashme. Qeverisja Lokale – Komunat – ka përgjegjësi specifike, si planifikimi strategjik lokal, monitorimi, inspektimi/zbatimi, regjistrimi/licensimi, mbledhja e të dhënave, raportimi dhe informimi dhe konsultimi me publikun.

Ligji për Ujërat themeloi Këshillin Ndërmintor për Ujëra si organ koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton sistematikisht çështjet e ujërave dhe propozon masa për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe të sistemit të Kosovës.²² Është paraparë që kryeministri i Kosovës të jetë njëri nga pesë anëtarët e këtij Këshilli.

Në përputhje me Ligjin, roli ekzekutiv për burimet ujore i takon Autoritetit të Pellgjeve Lumore, i cili është me seli në Prishtinë dhe i raporton Ministrit (MMPHI). Po ashtu, MMPHI-së i raporton edhe Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), i cili është përgjegjës për kryerjen e detyrave mbështetëse administrative, profesionale, shkencore dhe hetimore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. AMMK-ja raporton rregullisht për gjendjen e mjedisit, ndotjen e ujësjellësve, largimin e ujërave të zeza të patrajtuara, eutrofikimin dhe monitorimin e ujërave sipërfaqësore.

Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) është organ i pavarur rregullator përgjegjës për t'i raportuar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe është rregullatori kryesor licencues dhe ekonomik për sektorin e shërbimeve të ujit. Prandaj, roli kryesor i ARRU-së është të menaxhojë një kornizë rregullatore efektive, e cila i inkurajon ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë që të sigurojnë një shërbim cilësor në vlerën monetare të paguar nga konsumatorët.

Problemet me strukturën institucionale

Në praktikë është dëshmuar se ka disa probleme në këto institucione, duke përfshirë koordinimin dhe monitorimin e institucioneve të lartpërmendura.

²² Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 15, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659>

Për shembull, nuk ka koordinim dhe bashkëpunim të mirë mes Këshillit Ndërministror për Ujërat dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, por edhe me Zyrën e Kryeministrit.

Një çështje tjetër është se me këtë ligj janë paraparë të krijohen disa organe të pavarura, por jo të gjitha funksionojnë. Për shembull, Instituti i Kosovës për Ujëra duhej funksionalizuar me qëllim të zhvillimit, hulumtimit dhe projektimit të progresit, por kjo dispozitë nuk u jetësua asnjëherë dhe ky institut nuk funksionon.

Rekomandime

1. Të miratohet Ligji i ri për Ujërat në përputhje me *acquis* dhe praktikat më të mira të BE-së, me qëllim përmirësimin e gjendjes aktuale të ujërave dhe jo përkeqësimin e saj.
2. Të publikohet Strategjia Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017 – 2036 në ueb faqet zyrtare të institucioneve publike.
3. Të hartohet dhe miratohet Plani i Veprimit të Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 dhe një plan konkret për monitorimin e zbatimit të kësaj Strategjie.
4. Të përmirësohet monitorimi i zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes së ujërave.
5. Të zhvillohen dhe zbatohen Planet menaxhuese të Pellgjeve lumore, që përfshijnë edhe Planin për monitorimin e vazhdueshëm të tyre.
6. Të monitorohet procesi i ndërtimit të hidrocentraleve, të sigurohet se ndërtimi do të bëhet në respekt të plotë të legjislacionit mjedisor dhe të kalojë në vlerësimet e duhura mjedisore për shkak të efekteve të tyre të dëmshme kumulative mjedisore.
7. Të forcohen mekanizmat në MMPHI dhe të sigurohet që të gjitha licencat dhe lejet, veçanërisht për hidrocentralet, të jenë në përputhje me ligjin.
8. Të sigurohet se do të ketë përfshirje të publikut në vendimmarrje për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
9. Të identifikohen aglomeratet dhe zonat e ndjeshme, në përputhje me Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Mbetjeve Urbane.
10. Të zhvillohen strategji specifike për të përmirësuar investimet në objektet e trajtimit të ujërave të zeza; të funksionalizohen impiantet e ujërave të zeza për të pastruar lumenjtë nga ujërat e zeza; të identifikohen të gjitha ujërat e zeza të hapura në vend dhe të sigurohet mbyllja e tyre në mënyrë që të mos përbëjnë risk për banorët përreth.
11. Të miratohen dokumentet kyçe strategjike dhe planifikuese për përafrimin me legjislacionin dhe praktikën e BE-së për menaxhimin e ujërave.

12. Të forcohet koordinimi ndërmjet institucioneve publike që zbatojnë Ligjin për ujërat dhe punojnë në sektorin e ujërave.
13. Të ndërmerren veprime konkrete për ndëshkimin e ndotësve të resurseve ujore.

Koha të veprojmë!



Indotjan e ajrit

Foto: Yllka Fetahaj



2. Ndotja e Ajrit

Pasqyrë e përgjithshme

Kosova vuan nga cilësia e dobët e ajrit. Nivelet e ndotjes së ajrit në Prishtinë ndonjëherë mund të krahasohen me qytetet e mëdha si Pekini dhe Mumbai.²³ Kjo cilësi e ajrit është pasojë e ndotësve kryesorë në Kosovë të cilët janë grimcat 2.5 dhe 10, të njohura përkatësisht si PM2.5 dhe PM10, ozoni (O3), monoksidet e karbonit (CO), dioksidi i squfurit (SO2) dhe dioksidi i azotit (NO2), janë faktorët që nxisin ndotjen e ajrit që do të diskutohen më vonë në këtë kapitull.

Planifikimi për uljen e ndotjes së ajrit varet nga disponueshmëria e të dhënave dhe analizimi i tyre në mënyrë që gjetjet të inkorporohen në plane afatgjate. Reduktimi i ndotjes së ajrit nga ndikimi antropogjen rregullohet vetëm me vendosjen e legjislacionit dhe strategjive adekuate që e shënjestrojnë këtë problem në nivel qendror dhe lokal. Në Kosovë ekzistojnë këto politika mjedisore, mirëpo nuk ka masa që sigurojnë zbatimin e tyre.

Ndotja e ajrit është një çështje që duhet adresuar urgjentisht, pasi është një ndër faktorët kryesorë që shkakton shfaqjen e sëmundjeve në organet e sistemit respirator dhe vdekje të parakohshme. Reduktimi i funksionit të mushkërive, infeksionet e organeve të frymëmarrjes dhe astma e rënduar, janë pasojë e ekspozimit afatshkurtër dhe afatgjatë ndaj ajrit të ndotur. Prandaj reduktimi i kësaj ndotje është esencial për zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë.

Strategjia dhe Plani

"Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (2013 – 2022)" (SMM) u publikua nga MMPHI në vitin 2013. Strategjia e miratuar synonte "të adresojë në mënyrë specifike detyrimet e menaxhimit mjedisor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar".²⁴ Objektivat e SMM-së përfshinin "harmonizimin me acquis të BE-së" dhe "reduktimin gradual të ndotjes të ajrit, ujit dhe tokës".²⁵ Për sa i përket ndotjes së ajrit, SMM-ja ka ofruar një listë me prioritete, disa prej të cilave, si kompletimi i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit, janë plotësuar.²⁶ Prioritetet përfshijnë çështje lokale, si përmirësimi i transportit publik për të reduktuar emetimet nga derivatet dhe rritja e përdorimit të sistemeve të centralizuara të ngrohjes, dhe çështje mbarëkombëtare si zbatimi i legjislacionit dhe përmirësimi i bashkëpunimit të autoriteteve publike. SMM-ja gjithashtu thekson rëndësinë e edukimit mjedisor dhe vetëdijesimit të publikut për zhvillimin e politikave mjedisore. Strategjia shënon objektiva dhe prioritete të qarta për të ofruar një plan për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë.

23 Banka Botërore, MCA Rajonale e Ballkanit Perëndimor - Raporti i Ballkanit Perëndimor - MCA në Kosovë, Uashington D.C., SHBA, tetor 2019.

24 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor [MMPHI]. Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, Republika e Kosovës, Prishtinë, 2013, https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Strategjia_e_Mbrojtjes_s%C3%AB_Mjedisit_-_2013_-_2022_Shqip_748721.pdf

25 Po aty, 13.

26 Po aty, 21.

Në vitin 2018, MMPH-ja ka zhvilluar "Strategjinë për Ndryshimet Klimatike 2018-2027". Fokusi kryesor i kësaj strategjie është reduktimi i gazrave serë dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, gjë që do të nxiste zhvillimin e qëndrueshëm.²⁷ Objektivat kryesore për reduktimin e ndotjes së ajrit përfshijnë lëvizje më të mëdha drejt përmbushjes së direktivave të BE-së dhe reduktimit të gazrave serë. Gjithashtu një objektiv thelbësor është pjesëmarrja më e madhe nga qytetarët dhe strukturat, si organizatat joqeveritare dhe vetë qeveria.²⁸ Si krijuese e strategjisë, MMPH-ja ishte përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie. Grupi Punues Ndërministror për Ndryshimet Klimatike, i krijuar për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, do të përdoret për të ngritur një ekip përgjegjës për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e SNK/PV.

Plani Kombëtar i Reduktimit të Emetimeve (PKRE) (2018) u referohet udhëzimeve të politikave nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe deri në vitin 2027 mund të përdoret si një alternativë për përcaktimin e niveleve të emetimeve. Si nënshkruese e Traktatit të Komitetit të Energjisë (2006), nga Qeveria e Kosovës kërkohet të bëjë përmirësime në kufizimin e disa ndotësve të ajrit, si SO₂, NO_x dhe pluhuri.²⁹ Qëllimi i PKRE është të "zvogëlojë emetimet e ndotësve kryesorë nga impiantet e mëdha me djegie dhe ka të bëjë me objektivat e reduktimit të emetimeve për impiantet ekzistuese me djegie me një input termik të vlerësuar prej 50 Mw ose më shumë, të cilave u është dhënë leja për emetimet përpara 31 dhjetorit 1992".³⁰ Në qendër të PKRE janë termocentralet Kosova A dhe B. Është thelbësore që këto termocentralet të reduktojnë djegien e tyre "çdo vit duke filluar nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2027" për t'u siguruar që ato janë në përputhje me vlerat tavan të emetimeve të deklaruara nga Direktiva e BE-së 2010/ 75/BE. Plani kërkon një raport vjetor i cili do të përfshijë emetimet tavan dhe emetimet aktuale; një përshkrim të gjobave për impiantet që nuk respektojnë limitet, dhe jep detaje të niveleve ideale të reduktimit të ndotësve.³¹

Ndotësit	2014	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Pluhur ton/vit	15,175	5,255	3,993	3,302	1,556	883	885	475	475	475	475
SO _x ton/vit	12,746	12,757	11,112	10,150	10,111	11,077	11,125	9,497	9,497	9,497	6,129
NO _x ton/vit	21,412	21,176	13,890	10,239	8,948	8,829	5,563	6,129	6,129	6,129	6,129

Tabela 1. Emetimet tavan të kombinuara për impiantet e djegies së pjesëmarrësve të PKRE në Kosovë

27 MMPH, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028. Republika e Kosovës, Kosovë: Prishtinë. (2018), <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=29356>

28 Po aty, 52-53.

29 Republika e Kosovës. Plani Kombëtar i Reduktimit të Emetimeve, Kosovë: Prishtinë. (2018), 3.

30 Po aty, 5.

31 Po aty, 12.

Legjislacioni dhe zbatimi

Bashkimi Evropian (BE) prej kohësh ka direktiva të vendosura dhe të zbatuara për cilësinë dhe ndotjen e ajrit. Direktiva e Këshillit 96/62/EC e 27 shtatorit 1996 mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambientit synonte të krijonte një strategji të përbashkët në të gjithë shtetet anëtare për të vlerësuar cilësinë e ajrit të ambientit dhe për të marrë të dhëna adekuata për cilësinë e ajrit.³² Direktiva 2004/107/EC, e njohur si "Fourth Daughter Directive", synonte të monitoronte arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit.³³ Direktiva 2008/50/EC shfuqizoi të gjithë legjislacionin e mëparshëm për cilësinë e ajrit - përveç "Fourth Daughter Directive" - dhe vendosi "nevojën për të reduktuar ndotjen" dhe "mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit në tërësi".³⁴ Legjislacioni më i fundit ofron direktiva në lidhje me shkëmbimin e informacionit të cilësisë së ajrit dhe metodave, mbledhjen e të dhënave dhe marrjen e mostrave për vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambientit.³⁵

Qeveria e Kosovës ndjek legjislacionin e ngjashëm me atë të BE-së, duke njohur "nevojën për të harmonizuar standardet mjedisore në Kosovë me Bashkimin Evropian".³⁶ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 03/L-025) "do të harmonizojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm".³⁷ Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (Nr. 03/L-160), i cili është në proces të plotësimit-ndryshimit³⁸, është krijuar për të "rregulluar dhe garantuar të drejtat e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të shëndetshëm dhe të pastër". Korniza ligjore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja është plotësuar edhe me UA (aktet nënligjore), si;

- Udhëzim Administrativ (QRK)–Nr.06/2007) mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.04/2009) për kontrollin e emetimeve të bashke dyzimeve organike, të avullueshme gjatë deponimit, zbrazjes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve;
- Udhëzim Administrativ (ministri i MMPH) Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit;
- Udhëzim Administrativ–Nr.15/2010 për kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese për cilësinë e ajrit, numrin dhe shpeshtinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave;

32 Bashkimi Evropian [në tekstin e mëtejshëm BE]. Direktiva e Këshillit 96/62/EC e 27 shtatorit 1996 mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit të ambientit. [1996] CD 96/62/EC. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:31996L0062>.

33 BE. Direktiva 2004/107/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 dhjetor 2004 në lidhje me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit. [2004] 2004/107/EC. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32004L0107&from=en>.

34 BE. Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 maj 2008 për cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajër më të pastër për Evropën. [2008] 2008/107/EC. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32008L0050&from=en>.

35 Vendimi Zbatues i Komisionit 2011/850/EU; Direktiva 2015/1480/EC.

36 Kuvendi i Kosovës. Ligji nr. 2004/30 për Mbrojtjen e Ajrit. [2004] http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_30_en.pdf.

37 Republika e Kosovës. Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit. [2009]. [https://mmpfi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/pdf-test%20\(38\).pdf](https://mmpfi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/pdf-test%20(38).pdf).

38 Kuvendi i Kosovës. Projektligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja <https://www.google.com/url?q=https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw%3D263&sa=D&source=docs&ust=1655386299053739&usq=AOvVae2TsfIn88vi5FiJ5e50EdN3>

- Udhëzim administrativ (QRK)-Nr.21/2013 për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër;
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.16/2013 për substancat që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serë të fluoruara;
- Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr.19/2013 për qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emetimet e CO₂ të automjeteve të reja personale;
- Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr.01/2016 për mekanizmin e përcjelljes së emetimeve të gazrave serë;
- Udhëzim Administrativ (QRK) -Nr.08/2016 për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes.

Ligji Nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes synon të parandalojë ose reduktojë emetimet që ndotin ajrin, ujin dhe tokën.³⁹ Ndikimi mjedisor në ajër i projekteve të reja kërkohet ligjërisht të vlerësohet sipas Ligjit Nr. 03/L-214 dhe Ligjit Nr. 03/L-024 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.⁴⁰ Për më tepër, në vitin 2011, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor u krijua si autoritet për të vlerësuar cilësinë e ajrit dhe për të vendosur metodat dhe kriteret për cilësinë e ajrit të ambientit të specifikuar në direktivat e BE-së 2004/107/EC dhe 2008/50/EC.

Legjislacioni për cilësinë dhe vlerësimin e ajrit është i integruar mirë në sistemin ligjor të Kosovës dhe është në përputhje me direktivat e BE-së. Megjithatë, në Kosovë zbatimi i ligjeve është në shkallë të ulët.⁴¹

Si pjesë e integritit në BE, Komisioni Evropian shkruan një Raport vjetor mbi zhvillimin e Kosovës kundrejt *acquis* të BE-së. Çdo vit, ka një kapitull kushtuar mjedisit. Pavarësisht se Ligji për Mbrojtjen e Ajrit hyri në fuqi në vitin 2004, raporti i parë i KE-së i vitit 2005 nuk shënoi "asnjë përparim në fushën e cilësisë së ajrit".⁴² E njëjta gjë u vu re në vitin 2006, 2007 dhe 2008. Pra për katër vite me radhë, edhe pse ka miratuar një ligj që parasheh mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Kosova nuk ka arritur të mobilizojë mekanizma adekuatë për zbatimin e këtij ligji.

MMPH-ja, në vitin 2009, bleu pajisjet për të filluar zbatimin e një sistemi mobil të monitorimit të cilësisë së ajrit, por në vitin 2010, vetëm një nga katër stacionet ishte zbatuar me sukses.⁴³ Tri stacionet e tjera u krijuan në vitin 2011 dhe monitorimi i cilësisë së ajrit analizoi dioksidin e squfurit, oksidet e azotit, monoksidin e karbonit, ozonin dhe grimcat e suspenduara.

Komisioni Evropian raportoi se në vitin 2013 u shtuan stacione shtesë duke mundësuar monitorimin e cilësisë së ajrit të ambientit në të gjithë Kosovën. Megjithatë, zbatimi i monitorimit të cilësisë së ajrit ishte ende i dobët, pasi raportet për gjendjen e ajrit kishin

39 Republika e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes. http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Ligjet/2009_03-L-043_en.pdf.

40 Republika e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. [2010] [https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/pdf-test%20\(29\).pdf](https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/pdf-test%20(29).pdf).

41 Tchounikine, Mathilde. Cilësia e ajrit në Kosovë: drejt standardeve evropiane. Prishtinë, Kosovë: Instituti për Politika Zhvillimore, qershor 2019.

42 Komisioni Evropian [në tekstin e mëtejme KE]. "Raporti i Progresit për Kosovën 2005", Komisioni Evropian, Luksemburg: 2005.

43 KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2006"; KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2007"; KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2008".

vetëm informacione bazë dhe Komisioni Evropian deklaroi se mungesa e mirëmbajtjes në stacione "rrezikonte saktësinë e tyre".⁴⁴

Katër vjet më parë, Komisioni Evropian raportoi se sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit me të dhëna në kohë reale më në fund ishte funksional.⁴⁵ Në vitet 2019, 2020 dhe 2021, monitorimi i cilësisë së ajrit u vlerësua për arritjen e "njëfarë progresi", duke përfshirë edhe arritjen e qasshmërisë për publikun.⁴⁶ Përkundër kësaj, raporti i vitit 2020 theksoi se: "Financimi dhe kapacitetet e pamjaftueshme administrative pengojnë zbatimin e duhur të kornizës aktuale strategjike".⁴⁷ Në vitin 2021, planeve për cilësinë e ajrit u mungonin ende veprimet e mjaftueshme pasi "nuk janë përgatitur ende planet për zonat në të cilat nivelet e ndotësve i tejkalojnë qartë vlerat kufitare".⁴⁸

Legjislacioni për standardet e ajrit në Kosovë është i përcaktuar mirë në ligj. Megjithatë, zbatimi i ligjeve të tilla ka qenë jokonsistent nga Qeveria e Kosovës. Për të përmirësuar cilësinë e ajrit të ambientit dhe për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj, qeveria përballet me sfida të rëndësishme në përmirësimin e kornizës institucionale për menaxhimin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe zbatimin e ligjit, si dhe me mungesën e burimeve financiare.⁴⁹

Problemet Kryesore

Në Kosovë, kontribuuesit kryesorë në ndotjen e ajrit janë:

1. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Korporata Energjetike e Kosovës drejton dy termocentrale me thëngjill (linjit) në Obiliq, Kosovë. Impiantet, Kosova A dhe B janë aktive gjatë gjithë vitit dhe vazhdimisht kontribuojnë në nivelet e CO₂, SO₂, NO₂, O₃, Pb, pluhurit, dioksinave të tymit dhe PM_{2.5} dhe PM₁₀ në ajër. Banka Botërore e ka përshkruar Kosovën A si "burimin më të keq të ndotjes në Evropë".⁵⁰ Gjithashtu, në vitin 2017, viti i raportit të Bankës Botërore, tri stacionet e monitorimit të ajrit të ambientit të prekur nga aktivitetet e KEK-ut raportuan vlerat maksimale të lejuara (VML) për PM_{2.5} dhe PM₁₀ gjatë nëntë muajve të vitit.⁵¹ Emetimet e pluhurit nga Termocentrali A nuk kanë tejkalar vlerat kufitare të lejuara gjatë vitit 2021. Në Termocentralin B emetimet e pluhurit i kanë tejkalar deri në 8 herë vlerat kufitare të lejuara.⁵²

44 KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2014".

45 KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2018".

46 KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2019"; KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2020"; KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2021".

47 KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2020", 93.

48 KE, "Raporti i Progresit për Kosovën 2021", 100.

49 Banka Botërore, MCA në Kosovë.

50 Banka Botërore. "Implementimi, Përfundimi dhe Rezultatet Raport mbi dy Grante dhe një Kredi në shumën prej 9.90 milion SDR (14.7 milion dollarë ekuivalente) për Republikën e Kosovës për një projekt për Pastrimin e Sektorit të Energjisë dhe Rikuperimin e Tokës." Shkurt 2017, e qasur në Prill 2022, <https://documents1.worldbank.org/curated/zh/323961490279093640/pdf/ICR-Main-Document-P096181-2017-02-28-17-46-03202017.pdf>.

51 AMMK, "Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2017", MMPH, Kosovë: Prishtinë, (2017)

52 Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Dokumente%202022/Raporti%20vjetor%20i%20Ajrit%202021%20\(final%20280422\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Dokumente%202022/Raporti%20vjetor%20i%20Ajrit%202021%20(final%20280422).pdf)

Si pjesë e Instrumentit të Para-Anëtarësimit të Komisionit Evropian (IPA), 76.4 milionë euro u zotuan në financimin e BE-së për të siguruar filtra për Kosovën B në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi mjedisor i termocentralit në përputhje me Direktivën për Impiantet e Mëdha me Djegie (2001/80 /EC) dhe Direktivën për Emetimet Industriale (2010/75/BE).⁵³ Gjithashtu është raportuar se ka pasur një tendencë të uljes së përqendrimit të PM2.5 dhe PM10 ndërmjet viteve 2013 dhe 2020 që "mund të lidhet me masat e marra për uljen e ndotjes".⁵⁴ Megjithatë, në shkurt 2020, Sekretariati i Komunitetit Evropian të Energjisë nxorri "Opinionet e Arsyeshme" kundër Kosovës për dështimin në përmbushjen e tavaneve të PKRE-së në 2018 dhe 2019. Kjo do të thotë se nuk kishte një reduktim të konsiderueshëm të emetimeve të SO₂, NO₂ dhe pluhurit, siç kërkohet nga Direktiva për impiantet e mëdha me djegie.⁵⁵ Ende nevojitet punë nëse KEK-u dëshiron të zbusë ndikimin e vet mjedisor në cilësinë e ajrit.

2. Transporti rrugor, kryesisht brenda zonave urbane

Emetimet ndotëse nga automjetet janë rritur vazhdimisht për shkak të trafikut me intensitet të lartë dhe bllokimit në qendrat e qyteteve. Rritja e popullsisë ndikon edhe në numrin e automjeteve në rrugë. Mes viteve 2011 dhe 2021, numri i makinave u rrit mbi 89%.⁵⁶ Sektori i transportit është i përmbytur nga një numër i madh i automjeteve të vjetra dhe përdorimi i karburanteve me cilësi të ulët.⁵⁷ Moshë mesatare e shërbimit të një veture në Kosovë është nëntëmbëdhjetë vjet, krahasuar me rreth nëntë vjet në Evropën Perëndimore.⁵⁸ Si rezultat i këtyre faktorëve, vlerësohet se transporti rrugor përbën rreth 10% të emetimeve totale për Kosovën në vitin 2018.⁵⁹ Numri i veturave në rrugë është ende në rritje, dhe ka gjasa që këto automjete të jenë më të vjetra dhe për këtë arsye më ndotëse, prandaj është e nevojshme futja e legjislacionit të mëtejshëm dhe qasja në transportin publik modern për të minimizuar nivelet e ndotjes.

3. Druri dhe thëngjilli

Druri dhe thëngjilli janë burimet kryesore të energjisë për ngrohjen e shtëpive në Kosovë.⁶⁰ Numri më i madh i tejkalimeve të VML të PM10 në vitin 2020 u regjistrua në sezonin vjeshtë-dimër si rezultat i përdorimit të lëndëve djegëse në vend.⁶¹

Si masë për uljen e emetimeve të gazrave që ndikojnë në cilësinë e ajrit, qeveria e Kosovës ka rritur prodhimin e energjisë nga burimet alternative (uji, era), megjithatë përdorimi i

53 Komunikatë për shtyp e BE-së, "BE-ja ndihmon në trajtimin e ndotjes së ajrit në Kosovë me 76.4 milionë euro", 30 janar 2020, qasur më 12 prill 2022, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/MT/ip_20_141.

54 AMMK, "Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2020", MMPH, Kosovë: Prishtinë, (2020).

55 Komuniteti i Energjisë, "Sekretariati paraqet çështje kundër tre Palëve Kontraktuese për mos reduktimin e ndotjes së ajrit nga termocentralet", 23 shkurt 2022, qasur më 12 prill 2022, <https://energy-community.org/news/Energy-Community-Neës/2022/02/23a.html>.

56 Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Transportit", janar 2022, qasur më 12 prill 2022, <https://ask.rks.gov.net/media/6639/transport-statistics-q4-2021.pdf>.

57 MMPH, "Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit, 2013-2022," Republika e Kosovës, Prishtinë, 2013.

58 Banka Botërore, "Kosova: Një e ardhme e transportit të gjelbër dhe ajrit të pastër," qasur më 13 prill 2022, <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/32283/Kosovo-A-Future-of-Green-Transport-and-Clean-Air.pdf?sequence=1&isAllowed=y>.

59 Po aty, 10.

60 Banka Botërore, "MCA Rajonale e Ballkanit Perëndimor, MCA në Kosovë", tetor 2019, qasur më 13 prill 2022, <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/33041/Air-Pollution-Management-in-Kosovo.pdf?sequence=1&isAllowed=y>.

61 AMMK "Raporti Vjetor 2020".

thëngjillit si lëndë kryesore për prodhimin e energjisë nga KEK-u ende mbetet në nivel shumë të lartë, është shkaktari kryesor i ndotjes së ajrit, dhe mbetet larg harmonizimit me acquis të BE-së.

4. Industria

Zonat industriale janë gjithashtu një nga burimet kryesore të emetimeve të grimcave dhe të ndotësve të tjerë të ajrit, për shkak të teknologjive të vjetruara dhe përdorimit të lëndëve djegëse me përmbajtje të lartë squfuri. Sipas AMMK, burimet kryesore të ndotjes së ajrit përfshijnë, ndër të tjera, kompleksin industrial në Mitrovicë; nxjerrjen dhe shkrirjen e nikelit, plumbit dhe zinkut në Drenas; prodhimin e çimentos në Han të Elezit; ndërtimtarinë dhe gurthyesit; minierat e plumbit dhe mbeturinat e tyre mbeten burimet kryesore të emetimit të plumbit në Kosovë (Banka Botërore 2013). Automjetet kanë qenë burimi kryesor i emetimeve të plumbit derisa përmbajtja e plumbit në benzinë është rregulluar në vitin 2012. Maxhuni et al. (2015) gjeti se përqendrimet e ngritura të metaleve të rënda toksike, duke përfshirë kromin, nikelin, plumbin dhe zinkun, veçanërisht në pjesën perëndimore të Kosovës, dhe përqendrimet e plumbit në ambient në vend ishin mesatarisht gjashtë herë më të larta se mesatarja për vendet evropiane. Burimet industriale, duke përfshirë minierat, zonat industriale dhe trafikun, u identifikuan si burimet kryesore të emetimit të këtyre ndotësve të metaleve të rënda.⁶²

5. Bujqësia

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm për Kosovën; kontribuon me 11.9% në BPV dhe ofron mundësi zhvillimi dhe punësimi.⁶³ Bujqësia është kontribuuesi i dytë më i madh i emetimeve të gazrave serë, duke prodhuar 8% të emetimeve totale.⁶⁴ Shkaqet kryesore të emetimeve janë blegtoaria, shpyllëzimi dhe plehërimi i kulturave, të cilat të gjitha gjenerojnë sasi të shtuara të CO₂.⁶⁵ Ka një kërkesë të lartë për produkte bujqësore, si mish viçi dhe prodhimet e qumështit, që do të thotë se mund të vazhdojë të ketë një ndikim të lartë në emetimet e gazrave serë. Pavarësisht se është një sektor i rëndësishëm për Qeverinë e Kosovës, sektori i bujqësisë vuan nga një mori çështjesh, siç janë sistemet e dobëta të menaxhimit të tokës, sistemet e dobëta të prodhimit, mungesa e monitorimit dhe menaxhimit të të dhënave, dhe mbështetet në subvencionet qeveritare dhe ndërkombëtare.⁶⁶ Këta faktorë shtojnë ndotjen, jo vetëm në ajër, por edhe në ujë dhe tokë, duke kontribuar në çështje të tjera të lidhura me klimën, si eutrofikimi dhe toka jopjellore.

6. Mbeturinat

Sektori i mbetjeve shkakton rreth 3% të emetimeve të gazrave serë.⁶⁷ Në Kosovë mungon një sistem i integruar i menaxhimit të mbeturinave dhe praktikisht asnjë mbeturinë nuk riciklohet.⁶⁸ Edhe pse 90% e mbetjeve grumbullohen në zonat urbane, ka mungesë të

62 Banka Botërore, Menaxhimi i Ndotjes së Ajrit në Kosovë, Raport, tetor 2018.

63 MMPH, Strategjia për Ndryshimet Klimatike.

64 AMMK "Raporti Vjetor 2020".

65 MMPH, Strategjia për Ndryshimet Klimatike.

66 Fjolle Caka, "Lëvizja drejt Menaxhimit dhe Praktikave të Qëndrueshme të Tokës Bujqësore në Kosovë," WIT Transactions on Ecology and the Environment, Vol 249, 24. <https://www.witpress.com/Secure/elibrary/papers/SC20/SC20003FU1.pdf>.

67 MMPH, Strategjia për Ndryshimet Klimatike.

68 Banka Botërore, "Analiza Mjedisore e Shtetit të Kosovës", Vlerësimi i Kostos së Degradimit të Mjedisit, Rishikimi Institucional dhe Rishikimi i Shpenzimeve Publike Mjedisore, janar 2013.

grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale, gjë që inkurajon depozitimin e papërshtatshëm të mbetjeve. Mbetjet - të mbledhura nga autoritetet ose përmes vetë-depozitimit - shpesh hidhen, dërgohen në deponi ose digjen, gjë që kontribuon në emetime. Edhe hiri i thëngjillit dhe mbetjet e minierave hidhen, në vend që të mblidhen në mënyrë të sigurt ose të riciklohen.⁶⁹ Praktikrat aktuale të deponimit të mbetjeve çojnë në nivele të larta të ndotjes së tokës dhe ujërave, emetime të metanit dhe dioksinave dhe grimcave të imëta në ajër. Vlerësohet se asgjësimi i mbetjeve barazohet me 345,000 ton CO₂ dhe 2,300 ton PM10 në vit.⁷⁰ Nuk ka të dhëna të plota për menaxhimin e mbetjeve, gjë që paraqet problem në përpjekjet për përmirësimin e kushteve në vend.

Kapacitetet Institucionale

Që nga viti 2020, Kosova ka dymbëdhjetë stacione monitoruese dhe një stacion mobil që vlerësojnë cilësinë e ajrit në mbarë vendin. Pluhuri i grimcave (PM10, PM2.5), NO₂, SO₂, O₃ dhe CO₂, monitorohen në këto stacione.⁷¹ Raportimi i të dhënave mund të administrohet edhe përmes një sistemi online të raportimit të cilësisë së ajrit, i cili administrohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.⁷² Kjo mund t'i inkurajojë qytetarët që të informohen më shumë për cilësinë e ajrit në rajonin e tyre.

Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe ka bashkëpunuar me Millennium Foundation Kosovo në projektin "Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për cilësinë e ajrit, ndryshimin e sjelljes dhe shërbimet e komunikimit", që nënkupton se janë identifikuar burimet e ndotësve të ajrit për të gjithë territorin e Kosovës dhe është krijuar një inventar i emetimeve në ajër për Kosovën.⁷³ Inventari është një nga mjetet kryesore për menaxhimin e cilësisë së ajrit. Për AMMK-në, ai "siguron informacion përmes të cilit kuptojmë se cilët janë kontribuuesit relativ sipas aktiviteteve dhe burimeve, duke mundësuar kështu veprim efektiv për reduktimin e emetimeve dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit të ambientit".⁷⁴

Investimet

Investimet në sektorin e ajrit nuk janë në proporcion me ndotjen e ajrit që vjen nga burime të shumta. Gjatë vitit 2021, investimet në sektorin e ajrit ishin të limituara. Investimet nga buxheti publik në sektorin e ajrit për vitin 2021 janë orientuar për furnizim dhe mirëmbajtje të stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit që janë nën menaxhimin e AMMK-së (Tab.21). Pra nuk ka pasur investime në ndonjë aspekt tjetër për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Investimet e donatorëve në sektorin e ajrit për vitin 2021, ishin të nivelit të ulët. Në këtë drejtim, investimet e huaja vlerësohen më shumë në aspektin e vlerësimit dhe monitorimit

69 Po aty.

70 Po aty, 38-39.

71 AMMK "Raporti Vjetor 2020", 11.

72 Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, "Rrjeti shtetëror i monitorimit të cilësisë së ajrit", qasur më 20 prill 2020, <http://www.ihmk-rks.net/?page=2.21>.

73 AMMK "Raporti Vjetor 2020", 15.

74 Po aty, 16.

të ajrit dhe ndikimit në shëndet. Projektet nga donatorët që janë të ndërlidhura me sektorin e ajrit janë të paraqitura në tabelën më poshtë.⁷⁵

Emri i projektit	Donatori	Vlera e Projektit	Periudha e Zbatimit
Përmirësimi i performancës mjedisore të termocentralit Kosova B	BE-IPA	76,400,000.00 euro	2019-2022
Projekti "Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit"	JICA – Qeveria Japoneze	4,000,000.00 dollarë	2017-2021
Mbledhja e të dhënave mjedisore (Programi Threshold MCC)	MCC-SHBA	3,000,000.00 dollarë	2017-2021
Investimi në energji efiçente në sektorin e amvisërisë (Programi Threshold MCC)	MCC-SHBA	20,700,000.00 dollarë	2017-2021
Investimi në sistemin e ngrohjes qendrore (Programi Threshold MCC)	MCC-SHBA	10,900,000.00 dollarë	2017-2021
Ngritja e kapaciteteve për përdorimin e të dhënave mjedisore; projekt i bashkëpunimit mes AMMK-së dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Suedisë	SIDA	2,262,400.00 krona suedeze	2020-2023
Fuqizimi i regjistrit të ndotësve të mjedisit PRTR në vendet e Ballkanit dhe Moldavi	Qeveria Gjermane	355,301 euro	2021-2023
Pjesëmarrja në punën dhe programin e Agjencisë Evropiane të Mjedisit (projekt rajonal)	BE-IPA	Fondi IPA me shumë përfitues 2,480,202.00 euro	2018-2022
Tranzicione drejt emetimeve të ulëta dhe ekonomisë së qëndrueshme ndaj klimës në Ballkanin Perëndimor (TRATOLOW)	BE-IPA	Fondi IPA me shumë përfitues	2021-2022

Si rezultat i ndërhyrjes me investime nga Komisioni Evropian, JICA dhe MCC/MFK, MMPHI-ja e ka përmirësuar sistemin e komunikimit për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit. Përveç kësaj, gjatë vitit 2020, me mbështetjen e MCC/MFK, MMPHI-ja e ka përmirësuar vazhdimisht sistemin e komunikimit për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit që publikon të dhëna në kohë reale të cilësisë së ajrit dhe për parashikimin e AQI përmes portalit kombëtar të cilësisë së ajrit në <https://airqualitykosova.rks-gov.net/sq/>, si dhe ka raportuar përditësimin e të dhënave në Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) <https://airindex.eea.europa.eu/Map/AQI/Viewer/>. Gjithashtu publiku mund të ketë qasje në indeksin e cilësisë së ajrit përmes aplikacionit për telefon të mençur.⁷⁶

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, nga Ngrohja Termokos është nënshkruar kontrata për instalimin e nënstacioneve të reja, rezervuarit të nxehtësisë dhe sistemit SCADA. Kjo kontratë

75 Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK, [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Dokumente%202022/Raporti%20vjetor%20i%20Ajrit%202021%20\(final%20280422\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Dokumente%202022/Raporti%20vjetor%20i%20Ajrit%202021%20(final%20280422).pdf)

76 Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2020, AMMK

është nënshkruar në kuadër të projektit "Përmirësimi i ngrohjes qendrore në Prishtinë", i cili realizohet në sajë të mbështetjes së Bankës Gjermane për Zhvillim (Kfw). Sipas kontratës, në kryeqytet parashihet të instalohen 320 nënstacione të reja. Me këtë zgjerim të sistemit të ngrohjes qendrore në Prishtinë, do të ketë një ndikim domethënës në uljen e ndotjes së ajrit gjatë stinës së dimrit.

Rekomandimet

1. Qeveria e Kosovës duhet të marrë masa për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi. Pasi baza ligjore për ndotjen e ajrit është e rregulluar, mungon vetëm komponenti i fuqizimit të këtij legjislacioni.
2. Të monitorohet periodikisht zbatimi i strategjive afatgjata dhe afatshkurtra që të sigurohet arritja e rezultateve të synuara.
3. Të miratohet Strategjia e re të Energjisë që do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e ndotjes së ajrit, pasi që kjo strategji parasheh dekarbonizimin e sektorit të energjisë, i cili në Kosovë është i varur kryesisht nga djegia e thëngjillit.
4. Të investohet për uljen e ndotjes nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B. Qeveria e Kosovës duhet të investojë sa më shpejtë për instalimin e filtrave të ajrit në termocentralet tona, si masë e tranzicionit në energji të pastër.
5. Të realizohen investimet e domosdoshme në efikasitet të energjisë për reduktimin e ndotjes së ajrit. Kosova varet shumë nga burime fosile për furnizim me energji, prandaj rritja e efikasitetit të energjisë do të ndikojë në uljen e konsumit dhe paralelisht uljen e ndotjes së ajrit.
6. Të promovohet Transporti publik për të ndikuar në përmirësimin e gjendjes së ajrit. Transporti është një nga faktorët që ka ndikim domethënës në ndotjen e ajrit. Përdorimi i transportit urban do të rezultonte në uljen e numrit të makinave që qarkullojnë brenda qyteteve.
7. Të rriten kapacitetet për menaxhimin e pyjeve dhe rigjenerimin e zonave të degraduara. Zonat pyjore kanë rëndësi të veçantë për të arritur një balancë të emetimit dhe absorbimit të gazrave serë. Kosova, me një trend në rritje të shpyllëzimit, duhet ta kthejë vëmendjen tek konservimi dhe rikthimi i kësaj pasurie.
8. Ndotësit duhet të paguajnë. Në tërë Bashkimin Evropian dhe më gjerë, qeveritë tashmë kanë vendosur tarifa për taksimin e ndotësve të ajrit. Kosova duhet ta ndjekë këtë shembull, dhe t'i detyrojë industrinë ndotëse t'i ulin emetimet e gazrave serë.

Koha të veprojmë!



mbrojta e natyrës

3. Mbrojta e Natyrës



Pasqyrë e përgjithshme

Ndonëse Kosova është një vend i vogël, ajo shquhet për biodiversitetin e pasur. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë diversitet të pasur biologjik dhe të peisazheve me një llojllojshmëri të mirë floristike, vegjetative dhe faunistike, ku vlen të theksohet prania e llojeve relikte, endemike, si dhe e llojeve me rëndësi të veçantë. Me florë shumë llojesh, ndërsa me faunën më të pasur në Gadishullin Ballkanik, biodiversiteti i Kosovës është begati e çmuar e saj.⁷⁷

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2019) është 210, të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 1251814.1 ha, ose 11.53% të sipërfaqes së Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë:

- 19 Rezervate Strikte të Natyrës ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj.),
- 2 Parqe Kombëtare ("Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"),
- 182 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujëvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj.),
- 1 Park i Natyrës ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), kategori që nuk është sipas IUCN
- 5 Peizazhe të Mbrojtura (Gërmia, Shkugëza, Pishat e Deçanit, kompleksi i Pishave në Strazhë, komuna e Kaçanikut dhe kompleksi i Pishave në Shtime), dhe
- 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve ("Ligatina e Hencit-Radeves").

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", Parku i natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës", Peisazhi i Mbrojtur "Gërmia" dhe MNRV "Ujëvarat e Mirushës" etj.

Klasifikimi i Zonave të Mbrojtura në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës është pjesërisht në harmoni me Unionin Botëror për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Zonat e mbrojtura të natyrës sipas këtij Ligji klasifikohen në 7 kategori: rezervati strikt i natyrës, park kombëtar, zonë e veçantë e mbrojtur, park i natyrës, monument i natyrës, peisazh i mbrojtur, dhe monument i arkitekturës së parkut.⁷⁸

Mbrojtja e zonave natyrore në Kosovë është iniciuar gjatë viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar, me përcaktimin e disa rezervateve natyrore, si në Kozhnjer, Rusenicë, Gubavc etj., me më shumë zhvillime në këtë drejtim gjatë viteve tetëdhjetë, kur është shpallur parku i parë kombëtar, ai i Bjeshkëve të Sharrit. Kjo zonë e mbrojtur është zgjeruar tutje në vitin 2012. Një park tjetër kombëtar është shpallur në vitin 2014, ai i Bjeshkëve të Nemuna. Aktualisht, rreth

⁷⁷ https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Biodiversiteti%20IK/Biodiversiteti_i_Kosoves.pdf.

⁷⁸ [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_\(ok\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_(ok).pdf).

11.53% e territorit të Kosovës e ka statusin e zonës së mbrojtur ligjërisht. Megjithatë, mbrojtja e këtyre zonave dhe pasurisë llojore të organizmave të gjallë që jetojnë aty, mbetet ende sfiduese.

Krahasuar me vendet përreth, hulumtimet e organizmave të gjallë në Kosovë janë relativisht të vonshme dhe, rrjedhimisht, akoma nuk ka ndonjë inventar sistematik të biodiversitetit në përgjithësi. Sidomos janë të mangëta njohuritë e pasurisë llojore të shtazëve. Shumica e hulumtimeve faunistike në të kaluarën janë sporadike për grupe të caktuara, janë josistematike, si dhe janë kryer në zona të ngushta në Kosovë. Shumicës së këtyre hulumtimeve u ka munguar aspekti ekologjik që do të mundësonte ndërmarrjen e veprimeve konkrete për mbrojtjen apo konservimin e llojeve. Vetëm viteve të fundit, disa nga grupet e shtazëve janë hulumtuar më intensivisht, e kjo ka prodhuar edhe lloje të reja, e bile edhe gjini të reja për shkencën. Të gjitha këto hulumtime, të kryera gjatë disa dekadave në Kosovë, e sidomos bashkë me ato të realizuara në kuadër të projektit të Librit të Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës, tregojnë se Kosova, edhe pse me një territor të vogël, përmban një numër të madh të llojeve, të cilat shpeshherë janë të kufizuara në zona të ngushta dhe të cilat janë të rëndësishme në pikëpamje të konservimit në kontekstin më të gjerë evropian dhe global.⁷⁹

Flora

Disa lloje bimore janë endemike të Ballkanit, pra gjenden nëpër hapësirën ballkanike. Në vendin tonë mendohet se gjenden 2600–2800 lloje të ndryshme të bimëve të larta, në mesin e tyre përveç llojeve endemike ka edhe lloje stenoendemike. Këto të fundit janë lloje të cilat rriten vetëm në vendin tonë dhe askund tjetër dhe janë gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) lloje. Bimët stenoendemike janë të përhapura në vende të caktuara dhe kryesisht kanë shtrirje të vogël në aspektin hapësinor, numri i ekzemplarëve të tyre është i vogël dhe janë të pasura në aspektin floristik, rriten kryesisht në territorin e Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna".

Në vitin 2012 ishte botuar Atlas i Bimëve të Kosovës, i cili në vete përmbante të dhëna për gjithsej 902 lloje bimore. Që nga ajo kohë, ekipi i ekspertëve që ka marrë pjesë në hartimin e këtij atlas, ka vazhduar hulumtimet në terren dhe tani në Atlasin e Bimëve të Kosovës të publikuar në vitin 2021 sjell fotografi dhe të dhëna edhe për 228 lloje tjera bimore, duke rritur kështu numrin në 1,130 lloje bimore, dhe duke përfshirë 1/3 e bimëve të Kosovës, nga rreth 3,000 lloje bimore sa mendohet se janë në vendin tonë.

Bimët endemike të Kosovës janë të përhapura në vende të caktuara dhe kryesisht me shtrirje të vogël hapësinore; shpesh ato janë dhe në numër të pakët individësh. Është në interes të Kosovës që këto të mbrohen me ligj nga zhdukja, sepse mund të rrezikohen nga padituria ose përdorimi pa kujdes.

Bimët endemike janë pasuri floristike dhe ndeshen kryesisht në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit. Këto bimë janë të rralla, por njëherësh edhe krenari e Kosovës. Prej tyre në këtë Atlas janë përfshirë 11 lloje: *Stipa mayeri*, *Bornmuellera dieckii*, *Achillea alexandri-regis*, *Potentilla*

⁷⁹ [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_\(1\).pdf?fbclid=IwAR3EHo1OY7np6tRwRLwgEGlrEkXLPVXdLmucV7DxwOwfHK_VTxdtrOoa09o](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_(1).pdf?fbclid=IwAR3EHo1OY7np6tRwRLwgEGlrEkXLPVXdLmucV7DxwOwfHK_VTxdtrOoa09o)

doerleri, *Micromeria albanica*, *wulfenia bleicii*, *Plantago dardanae*, *Tulipa kosovarica*, *Centaurea alberti*, *Solenanthus krasniqii* dhe *Cerastium neoscardicum*. Ky Atlas përmban 103 lloje të bimëve endemike të Ballkanit dhe 18 lloje endemike të Kosovës dhe Shqipërisë.⁸⁰

Fauna

Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës është dokumenti më i rëndësishëm zyrtar i prodhuar deri më tani në Kosovë sa i përket diversitetit të faunës, sepse jep për herë të parë të dhëna cilësore dhe të matshme rreth llojeve të shtazëve të pranishme në Kosovë, shtrirjes së tyre, aspekteve të endemizmit, dhe masave për mbrojtjen e tyre. Duke i identifikuar në të njëjtën kohë edhe kërcënimet që u kanosen këtyre llojeve, ky dokument do të shërbejë si udhërrëfyes për mbrojtjen e llojeve, evitimin e kërcënueshmërisë ndaj tyre dhe krijimin e politikave për konservim.

Në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës janë përfshirë gjithsej 306 lloje, të cilat u takojnë këtyre grupeve të shtazëve: *Gastropoda*, *Bivalvia*, *Oligochaeta*, *Hirudinea*, *Arachnida* (*Araneae*, *Mesostigmata*), *Malacostraca*, *Diplopoda*, *Insecta* (*Ephemeroptera*, *Plecoptera*, *Odonata*, *Coleoptera*, *Mecoptera*, *Diptera*, *Trichoptera*, *Lepidoptera*), *Cyclostomata*, *Actinopterygii*, *Amphibia*, *Reptilia*, *Aves* dhe *Mammalia*. Numri i llojeve të vëzhguara është shumë më i madh, por për shkak të hapësirës së kufizuar, vlerësimi është bërë vetëm për këto lloje. Gjatë zbatimit të Komponentit të Dytë për Librin e Kuq në kuadër të Programit Mjedisor të Kosovës, në aktivitetet e hulumtimit të kafshëve është gjetur një lloj i ri për shkencën, i cili i takon grupit *Insecta*, rendit *Trichoptera* dhe gjinisë *Potamophylax*, që është grup endemik i Ballkanit me përhapje të ngushtë.

Një numër i madh i llojeve të *Ephemeroptera*-ve, *Coleoptera*-ve, *Mollusca*-ve, *Araneae*-ve dhe të tjera bëjnë pjesë në këtë grup të materialit të paidentifikuar ende, dhe përfundimi i përcaktimit të tyre mund të krijojë rezultate të rëndësishme për faunën e Republikës së Kosovës.

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës i takon grupeve: *Insecta* (140 lloje), *Mammalia* (39), *Aves* (24), *Reptilia* (20) dhe *Gastropoda* (20), kurse grupet e tjera janë të përfaqësuara me numër më të vogël të llojeve.

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës i takon kategorive: Të dhëna të Pamjaftueshme (gjithsej 90) dhe Gati i Kërcënuar (gjithsej 80), kurse numri më i vogël i llojeve i takon kategorive: I Rrezikuar (24) dhe Skajshmërisht i Rrezikuar (25).

Këto të dhëna reflektojnë gjendjen faktike në hulumtimet e diversitetit shtazor në Kosovë, ku akoma ka mungesa thelbësore për një numër të madh të llojeve sa i përket të dhënave rreth popullatave, numrit të individëve, trendit të tyre dhe faktorëve që i kërcënojnë. Ky është një paralajmërim emergjent që të fillohet monitorimi i llojeve të tilla, në mënyrë që llojet të cilat nuk kanë mundur të vlerësohen për kategoritë e kërcënueshmërisë për shkak të mungesës

⁸⁰ https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Atlasi_i_bimeve_WEB_version_ammk.pdf

se te dhënave, të vlerësohen drejt, para se ato të rrezikohen në mënyrë të pakthyeshme prej risqeve antropogjene dhe të tjera.⁸¹

Vegjetacioni

Kosova shquhet me një vegjetacion mjaft të pasur që formon ekosisteme karakteristike, të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje shtazore. Pyjet më të zhvilluara gjenden brenda të Parqeve Kombëtare "Mali i Sharrit" dhe "Bjeshkët e Nemuna"; vegjetacioni i tyre përbëhet nga tre breza vegjetativë, brezi i ulët malor, brezi i mesëm malor, dhe brezi i lartë malor. Këto bashkësi pyjore paraqesin ekosisteme shumë të rëndësishme, që si të tilla duhet të ruhen, sepse me ruajtjen e këtyre resurseve krijohen kushte për ruajtjen edhe të llojeve bimore dhe shtazore. Mirëpo në disa raste janë shkaktuar ndërhyrje në vegjetacionin pyjor, si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në mjedis, si për shembull ndërtimi i rrugëve, prerja ilegale, djegia, aktiviteti i gurëthyesve, etj. Prandaj, këto dukuri kanë shkaktuar ndikime negative në vlerat natyrore dhe të ekosistemeve në përgjithësi.⁸²

Në tri vitet e fundit janë ndezur rreth 20 zjarre në Bjeshkët e Sharrit duke dëmtuar jo pak sipërfaqe të parkut.

Zjarret në Parkun e Sharrit gjatë periudhës 2017-2020:

- Viti 2017: kanë qenë 6 zjarre në zonat malore Kortinik, Bjeshka e Kabashit, Oshlak, Konjushkë, Kobicë dhe Vrtop. Dëmet kanë qenë kryesisht në vegjetacionin barishtor në sipërfaqe rreth 3 ha.
- Viti 2018: kanë qenë 5 zjarre në zonat malore Bjeshka e Dellocit, Kobicë, Konjushkë, Koxha Ballkan, dhe Gotovush. Janë dëmtuar kryesisht vegjetacionet barishtore në sipërfaqe prej rreth 2 ha.
- Viti 2019: kanë qenë 8 zjarre më të theksuara: 5 zjarre në zonat malore të Brodit dhe Firajës (komuna e Shtërpçës) dhe 3 zjarre në rajonet e fshatrave Brod, Restelicë dhe Krushëve (komuna e Dragashit). Janë dëmtuar kryesisht sipërfaqet barishtore (kullosat) në sipërfaqe rreth 100 ha.

Viti 2020: Veçohet zjarri në rajonin e fshati Manasterica ku janë djegur sipërfaqet barishtore dhe shkurre në sipërfaqe prej 2 ha".⁸³

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës.

Ka ende zona të mbrojtura që gëzojnë status të veçantë të mbrojtjes të cilat ende nuk kanë organe menaxhuese përkatëse. Problem vlerësohet të jetë edhe mungesa e planeve hapësinore, menaxhuese dhe rregulluese për disa nga këto zona.

81 [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_\(1\).pdf?fbclid=IéAR3EHo1OY7np6tRèRLègEGlrEkXLpVXdLmucV7Dxè0èfHK_VTxdtR0oa09o](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_(1).pdf?fbclid=IéAR3EHo1OY7np6tRèRLègEGlrEkXLpVXdLmucV7Dxè0èfHK_VTxdtR0oa09o).

82 https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Biodiversiteti%20IK/Biodiversiteti_i_Kosoves.pdf.

83 <http://qendrapress.com/flet-drejtori-i-parkut-kombetar-sharri-ne-3-vitet-e-fundit-nga-zjarret-jane-djegur-mbi-100-hektare/>.

Ndërtimet apo investimet për aktivitete rekreative nga Ministria apo Komuna në zonat e mbrojtura të Natyrës kanë shumë shkelje ligjore ose disa nuk kanë as leje mjedisore. Në Parkun dhe Ujëvarat e Mirushës nuk është respektuar as plani hapësinor i Mirushës, është degraduar zona e parë dhe zona e dytë që janë zona strikte, ndërkohë që ky projekt i financuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk ka as leje mjedisore, as vlerësimin të ndikimit në mjedis, as debat publik, e as përfshirje të qytetarëve në vendimmarrje, ashtu siç e kërkon edhe vetë ligji për mbrojtjen e natyrës.⁸⁴

Në rastin e ndërtimit të Parkut të Aventurave në Peisazhin e Mbrojtur të Gërmisë, po ashtu nuk është respektuar as rekomandimi i Institutit për Mbrojtjen e Natyrës të Kosovës, nuk ka pasur as dëgjese publike, as vlerësim të ndikimit në mjedis, si dhe Komuna i ka tejkalluar kompetencat e saja.⁸⁵

Në të dy rastet shihet qartazi një bashkëpunim dhe koordinim mes Ministrisë dhe Komunës për dhënien e pëlqimeve dhe lejimin e shkeljeve ligjore.

Inspektorati mjedisor nuk reagon në kohë dhe nuk merr masa të mjaftueshme për parandalim, edhe si rezultat i numrit të vogël të inspektorëve të mjedisit.

Zonat e Mbrojtura të Natyrës janë në risk po ashtu nga ndërtimet ilegale të vilave, hoteleve dhe restoranteve të ndryshme, si dhe nga lëvizjet e pakontrolluara të vizitorëve që askush nuk i parandalon. Ndërkohë, edhe aktivitetet me leje mjedisore kanë shumë keqpërdorime.

Për rastin "Brezovica", deri më tani Prokuroria Themelore në Ferizaj ka arrestuar 26 persona, ndër ta edhe zyrtarë të lartë të Ministrisë si dhe Kryetar të Komunës e shumë zyrtarë të tjerë të përfshirë.⁸⁶

Në emër të zhvillimit ekonomik dhe turizmit investohet pa ndonjë plan të hollësishëm dhe të detajuar që do të garantonte zhvillim të qëndrueshëm, por përkundrazi, këto zhvillime të egra dhe të pamonitoruara do ta degradojnë Natyrën. Zonat e mbrojtura të Natyrës përballen me një buxhet shumë të vogël, me mungesë të një vizioni të qartë, dhe deri më tani në Republikën e Kosovës nuk ka qenë prioritet mbrojtja e Natyrës.

Strategjia dhe Plani

Kosova e ka në masë të kënaqshme të zhvilluar kornizën strategjike dhe programore për mjedisin dhe sektorët e tij, mirëpo niveli i zbatimit është ende në shkallë të ulët. Në tabelën 35 prezantohen dokumentet kryesore strategjike dhe programore të sektorit të mjedisit dhe niveli i zbatimit të tyre.⁸⁷

84 <https://ekonomiaonline.com/nacionale/dorezohet-kallezim-penal-per-degradimin-e-ujevares-dhe-parkut-te-mirushes/>.

85 <https://kallxo.com/komuna/gjykata-supreme-le-ne-fuqi-vendimin-per-pezuillim-te-projektit-parku-i-aventurave-ne-germi/>.

86 <https://gazetainfokus.com/rasti-brezovica-26-te-arrestuar-19-nga-ta-ne-paraburgim-dhe-afer-6-milione-euro-te-bllokuara/>.

87 [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_\(ok\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_(ok).pdf).

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Niveli i zbatimit
Strategjia Mjedisore e Kosovës dhe Plani Kombëtar i Veprimit Mjedisor	2013-2022	Approved by the Government of the Republic of Kosovo by Decision No. 05/140, of 17.07.2013	Nuk ka filluar së zbatuari për shkak të paqartësisë në procesin e aprovimit
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet	2011-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/140, datë 17.07.2013	Pjesërisht
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Aktualisht është në proces të rishikimit)	Pjesërisht
Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit	2018-2020	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Në fazën fillestare të zbatimit
Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	Në proces të rishikimit	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Në proces të rishikimit
Strategjia dhe Plani Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2017-2026	Në proces të rishikimit	Në fazën fillestare të zbatimit
Strategjia Shtetërore e Ujërave	2017-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/90, datë 19.02.2019	Zbatimi në fazën fillestare
Plani Hapësinor i Kosovës Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës	2010-2020+	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2018	Pjesërisht – në proces të zbatimit harta zonale e Kosovës
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri"	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht – në proces të aprovimit edhe dy plane rregulluese
Plani Hapësinor për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës"	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Nuk ka filluar zbatimi në mungesë të organit menaxhues për këtë zonë të mbrojtur

Plani Hapësinorë për Zonën e mbrojtur me Interes të veçantë "Beteja e Koshares"	2014-2023	Miraturar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Hapësinorë për Zonën me Interes të veçantë "Shtabi i përgjithshëm i UÇK-se, Kleçkë dhe Divjakë"	2014-2023	Miraturar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Hapësinorë për Zonën me Interes të veçantë "Fusha e Mihjes së re"	2010-2020	Miraturar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Sharri"	2015-2024	Miraturar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht

Legjislacioni dhe zbatimi

Kosova ka një kornizë të elaboruar ligjore për mbrojtjen e mjedisit. Kushtetuta njeh mbrojtjen mjedisore si një nga parimet në të cilat bazohet Republika e Kosovës. Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës i obligon institucionet e qeverisjes publike që të angazhohen në garantimin e të drejtës për pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Ligjet kryesore që kanë të bëjnë me mjedisin përfshijnë Ligjin Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, Ligjin Nr.03/L-025 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, Ligjin Nr. 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor, Ligjin Nr.04/L-087 për parkun kombëtar "Sharri", Ligjin Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Ligjin Nr. 04/L-060 për mbeturina, Ligjin Nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Megjithatë, rishikimi funksional, duke krahasuar direktivat, rregulloret dhe vendimet e BE-së me aktet e nxjerra në Kosovë, ka treguar se kërkohet punë e madhe për ta sjellë Kosovën në vijë me direktivat e BE-së, në veçanti në nxjerrjen e udhëzimeve administrative. Zbatimi i legjislacionit mjedisor mbetet sfidë e madhe (KE 2010 dhe 2011).⁸⁸

- Ligji Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës⁸⁹
- Ligji Nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit⁹⁰
- Ligji Nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis⁹¹
- Ligji Nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor⁹²
- Udhëzim Administrativ QRK Nr. 18/2013 për shpalljen e rrejtës ekologjik
- Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr.01 /2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 03/2016 për caktimin e tarifave për lëshimin e

88 <https://WEB.worldbank.org/archive/WEBSITE01352/WEB/IMAGES/KOSOV-10.PDF>.

89 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>.

90 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>.

91 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708#>.

92 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>.

pëlqimeve, lejeve, licencave, certifikatave dhe vërtetimeve të parapara me legjislacionin për mbrojtjen e natyrës (shfuqizuar me vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021)

- Udhëzim Administrativ MEA - Nr. 12 /2020 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura
- Udhëzim Administrativ MMPH- Nr. 05 /2018 për përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për mbikëqyrësit e zonave të mbrojtura (shfuqizuar me vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021)
- Rregullore MMPH - Nr.23/2014 për rendin e brendshëm të monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë "Shpella e Gadimës"
- Udhëzim Administrativ MMPH – Nr. 24/2014 për klasifikimin e vlerave të mbrojtura të natyrës sipas rëndësisë
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr.02/2015 për lejimin e zbatimit të hulumtimeve shkencore në natyrë (shfuqizuar me vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021)
- Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr. 23/2013 Për Mënyrën Dhe Kushtet E Kryerjes Së Punëve Të Rojtarëve Të Natyrës
- Udhëzim Administrativ MMPH- Nr. 05 /2018 për përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për mbikëqyrësit e zonave të mbrojtura (shfuqizuar me vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021)
- Rregullore Nr.21/2013 për rendin e brendshëm të parqeve kombëtare
- Udhëzim Administrativ Nr.19/2013 për vlerësimin e pranueshmërisë së planit, programit ose ndërhyrjes në rrjetin ekologjik
- Udhëzim Administrativ Nr. 14/2013 për mënyrën e hartimit dhe zbatimit të studimit për vlerësimin e rrezikut nga futja, rifutja dhe kultivimi i llojeve të egra
- Udhëzim Administrativ MMPH-Nr.15/2014 për parandalimin dhe kompensimin e demit që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura
- Udhëzim Administrativ Nr.06.2013 për llojin, dukjen, procedurën dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve dhe shpërblimeve për të arriturat në lëmin e mbrojtjes së natyrës
- Udhëzim Administrativ Nr.07/2013 për shenjen e mbrojtjes së natyrës
- Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 për formën dhe mënyrën e dhënies së kartës dhe shenjës zyrtare për inspektorin për mbrojtjen e natyrës
- Udhëzimin Administrativ Nr. 26/2012 për qarkullimin ndërkufitar dhe tregtinë me llojet e egra të mbrojtura
- Udhëzimi Administrativ Nr. 24/2012 për përmbajtjen, formën, dhe mënyrën e lëshimit të kartelave identifikuese si dhe dukjen e uniformes të mbikëqyrësit dhe rojtarit të natyrës
- Udhëzim Administrativ Nr. 16/2012 për vendkalimet e shtazëve të egra
- Udhëzim Administrativ Nr. 07/2012 për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të regjistrit të vlerave të mbrojtura të natyrës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2012 për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim
- Udhëzimi Administrativ Nr.12/2011 – për llojet e tipave të vendbanimeve natyrore, hartat e vendbanimeve natyrore, tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave të vendbanimeve natyrore

- Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për dhënien e lejes mjedisore komunale
- Ligji Nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Udhëzim Administrativ MMPH- Nr. 10 /2017 për licencim të hartuesve të raporteve për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 16/2015 për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesit në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 08/2015 për përcaktimin e vlerës së tarifës për shërbimet lidhur me procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis
- Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2012 për përcaktimin e dokumenteve për aplikacion për pëlqim mjedisor sipas llojit dhe natyrës së produkteve
- Udhëzim Administrativ Nr. 07/2011 për licencim të hartuesve të raporteve për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2011 për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesit në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis
- Ligji Nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit
- Udhëzues Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor⁹³

Kërkesat e Konventës së Biodiversitetit dhe Traktateve tjera ndërkombëtare

Kosova, si shtet i ri, nuk është palë nënshkruese e asnjë konvente apo palë në ndonjë marrëveshje në fushën e mbrojtjes së natyrës, çka do ta detyronte për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre. Ka shpresa se Kosova së shpejti do të bëhet palë nënshkruese e Konventës për Diversitetin Biologjik dhe do të jetë e detyruar të ketë SPVB. Kjo strategji synon të përmbushë detyrimet ndaj konventave të tjera, të tilla si Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara (CITES), Konventa mbi Llojet Migratore, Konventa për Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore, Konventa për Ligatinat dhe tjerat.⁹⁴

Kosova ndjek plan zhvillimor të bazuar në të njëjtën ide, dhe ilustruesi më i mirë i kësaj është miratimi nga Kuvendi i rezolutës për ndërmarrjen e hapave drejt arritjes së Agjendës 2030. Rezoluta u miratua me qëllim krijimin e partneritetit me akterë të ndryshëm për zbatimin e agjendës dhe funksionalizimin e Këshillit për monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të OZHQ-ve. Të dy rezultatet përfundimtare të rezolutës janë lënë vetëm në diskursin retorik. Partneriteti ka qenë i palëvizshëm, pa bërë asnjë përpjekje të dukshme për përmbushjen e Agjendës 2030.⁹⁵⁹⁶

Niveli i zbatimit ligjor

Zbatimi ligjor mbetet ende sfide për Institucionet në Kosovë për mbrojtjen e Natyrës; kemi shumë raste, si në lejet ujore sidomos për hidrocentrale dhe ashtu edhe ato mjedisore në

93 http://unhabitat-kosovo.org/old/repository/docs/2_Udhezues_per_hartimin_e_Vleresimit_Strategjik_Mjedisor_932520.pdf

94 <https://WEB.worldbank.org/archive/WEBSITE01352/WEB/IMAGES/KOSOV-10.PDF>.

95 https://indep.info/wp-content/uploads/2019/07/SDG_ALB.pdf.

96 <https://WEB.worldbank.org/archive/WEBSITE01352/WEB/IMAGES/KOSOV-10.PDF>.

Zonat e mbrojtura, ku organizatat joqeveritare kanë gjetur shkelje të rënda të zbatimit të ligjit në dhënien e lejeve, dhe është bërë padi ndaj Ministrisë dhe komunave përkatëse.⁹⁷⁹⁸⁹⁹¹⁰⁰¹⁰¹

Problemet Kryesore

Në mungese të buxhetit adekuat për mbrojtjen e biodiversitetit, si dhe në mungesë të monitorimit dhe kapaciteteve profesionale institucionale, biodiversiteti në Kosove gjendet në risk shumë të madh.

Ka mungesë të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit në përgjithësi apo llojeve të veçanta në veçanti. Konsiderohen si pozitive dhe me rëndësi zbatimi i disa iniciativave dhe projekteve për menaxhimin ndërkufitarë të zonave natyrore.

Ndër faktorët kryesorë që rrezikojnë biodiversitetin në Kosove janë:

- përdorimi i burimeve biologjike (prerja dhe vjelja e pyjeve),
- ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (aktivitetet rekreative),
- modifikimet e sistemeve natyrore, digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujërave,
- eksploatimi i ujëra sipërfaqësore (përdorimi në amvisëri dhe bujqësi),
- ndotja (ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, kanalizimet),
- ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Faktorët e tjerë që kërcënojnë po ashtu janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët, zjarret dhe luftimi i tyre, modifikime të tjera të ekosistemit, zhvillimi rezidencial dhe komercial (banimi dhe zonat urbane), përdorimi i burimeve biologjike (mbledhja e bimëve tokësore), mbeturinat dhe mbetjet e ngurta, thatësitat, gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore, përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar), peshkimi dhe përdorimi i resurseve ujore, llojet jo native invazive, sëmundjet e huaja, materiale të futura gjenetike, degradimi dhe shkatërrimi i habitatit, grabitja, gjuetia dhe përndjekja nga njeriu për qëllime të ndryshme, aplikimi i kimikateve të ndryshme në bujqësi, transformimi i zonave bujqësore nga ekstensive në intensive, si dhe ndryshimi i praktikave bujqësore.¹⁰²¹⁰³

Kapacitetet Institucionale

Përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen mjedisore dhe menaxhimin mjedisor e ka Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), e cila ka përgjegjësinë për përcaktimin e politikave mjedisore të vendit. MMPHI-ja ka një Departament për mbrojtjen e

97 <https://ekonomiaonline.com/nacionale/dorezohet-kallem-penal-per-degradimin-e-ujevares-dhe-parkut-te-mirushes/>

98 <https://kallxo.com/komuna/gjykata-supreme-le-ne-fuqi-vendimin-per-pezuillim-te-projektit-parku-i-aventurave-ne-germi/>

99 <https://kallxo.com/laim/dorezohet-padi-ndaj-ministrise-dhe-zrre-se-per-lejet-e-hidrocentraleve-ne-gryken-e-decanit/>

100 <https://demokracia.com/gjykata-supreme-rikthen-masen-pezuilluese-mbi-punen-e-hidrocentralit-ne-brezovice/>

101 <https://ekonomiaonline.com/nacionale/glps-dhe-ojq-giethi-kane-paraqitur-padi-per-konflikt-administrativ-per-te-kontestuar-lejen-ujore-dhe-lejen-mjedisore-per-hidrocentralin-lepenci-3-ne-kacanik/?1>

102 [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_\(1\).pdf?fbclid=IwAR3EHo1OY7np6tRwRLwgEGlrEkXLpVXdLmucV7DxwOwfHK_VTxdrOoa09o](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_(1).pdf?fbclid=IwAR3EHo1OY7np6tRwRLwgEGlrEkXLpVXdLmucV7DxwOwfHK_VTxdrOoa09o)

103 [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_\(ok\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_(ok).pdf)

natyrës, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e ajrit dhe çështjet industriale, si dhe ka Departamentin për ujëra. Inspektorati mjedisor është nën Ministrinë e Mjedisit dhe ka përgjegjësi për aktivitetet e inspektimit.

MMPHI-ja ka pak resurse, përderisa buxheti relativisht i ulët i saj është zvogëluar tutje në vitin 2011, duke paraqitur sfidë më të madhe ndaj rolit të saj në menaxhimin mjedisor dhe përcaktimin e politikave (KE2011, shih edhe kapitullin 8).

Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është përgjegjës për detyrat profesionale, përkrahëse, shkencore dhe hulumtuese, përfshirë monitorimin mjedisor, menaxhimin e informatave mjedisore, dhe për hulumtim. Ai gjithashtu ka disa përgjegjësi administrative, siç janë nxjerrja e opinioneve rreth vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për pajtueshmërinë mjedisore për lejet e ndërtimit, dhënien e mendimeve për zonat e mbrojtura të natyrës, dhe organizimin e Sistemit Informativ për mbrojtjen mjedisore (Sida 2009 dhe Udhëzimi administrativ Nr. 22/03 për krijimin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës). AMMK ka tri drejtori: për monitorim, për sisteme informative, programe dhe raporte. Organet e tjera qeveritare me përgjegjësi për mjedisin përfshijnë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë Pyjore të Kosovës, Ministrinë për Energji dhe Miniera, përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të energjisë dhe minierave, për promovimin e zvogëlimit të ndotjes mjedisore në këta dy sektorë, për efikasitet të energjisë, dhe për energjinë e ripërtërishme, e cila u transformua në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në vitin 2011, dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve të minierave. KPMM nxjerr licencat për eksplorim dhe miniera, një proces që shpeshherë kërkon pajtueshmërinë mjedisore nga MMPH-ja (shpeshherë në bazë të vlerësimit të ndikimit në mjedis), Agjencinë Pyjore të Kosovës, si dhe komunat. Lëshimi i licencave kërkon koordinim më të mirë mes agjencive me përgjegjësi mjedisore (KE 2011).

Komunat e kanë për detyrë mbrojtjen e mjedisit, monitorimin dhe menaxhimin e resurseve natyrore brenda kufijve të tyre (Sida 2009). Disa komuna e kanë një njësi mjedisore, zakonisht brenda Departamentit të planifikimit urban, shpeshherë me vetëm një apo dy punonjës. Transferimi i disa përgjegjësive nga qeveria qendrore në qeverisjen lokale gjatë periudhës 2009-2010 i ka ngarkuar edhe më shumë resurset tashmë të kufizuara komunale (KE 2009a).¹⁰⁴

Në kuadër të ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore gjatë kësaj periudhe veçohen:

- Mungesa e rrjetit për monitorimin e ujerave nëntokësore;
- Mungesa e kapaciteteve në institucione përkatëse (MMPHI, IHMK), përveç në UP, për monitorim të parametrave biologjike/ekologjikë të ujërave sipërfaqësore;
- Mungesa e një institucioni të veçantë në nivel qendror për monitorimin e kimikateve;
- Numri i vogël i programeve edukative të nivelit bachelor dhe master në fushën e mjedisit;

104 <https://WEB.worldbank.org/archive/WEBSITE01352/WEB/IMAGES/KOSOV-10.PDF>.

- Numri i vogël i stafit në sektorin e natyrës e sidomos në Institutin për Mbrojtje të Natyrës;
- Mosfunktionalizimi i Bordit Këshillëdhënës për Mjedisin;
- Largimi i stafit të trajnuar dhe më përvojë nga institucionet përgjegjëse të sektorit të mjedisit për shkak të pagave të ulëta
- Kapacitetet e limituara të komunave në sektorin e mjedisit;
- Numri i vogël i inspektorëve të mjedisit në nivel qendror dhe lokal;
- Moscertifikimi i zyrtarëve (rojeve të natyrës) dhe numri i kufizuar i stafit profesional (zyrtarëve mbikëqyrës të natyrës) në Drejtorinë për Administrimin e Parqeve Kombëtare;
- Numri i kufizuar i stafit të rregullt në Drejtorinë për Administrimin e Monumenteve Natyrore me Rëndësi të Veçantë;
- Bordi Këshillëdhënës për Mjedisin ende është jashtë funksionit dhe nuk ka iniciativa për themelimin e tij, edhe pse është i paraparë sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Mosfunktionalizimi i Ekofondit apo një fondi/programi të veçantë për mjedisin;
- Të hyrat e arkëtuara në emër të mbrojtjes së mjedisit derdhen në Buxhetin e Kosovës por nuk shfrytëzohen për projekte mjedisore;
- Moszbatimi i plotë i Rregullores (QRK) Nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë;
- Mungesa e koordinimit të institucioneve relevante për procedimin dhe aprovimin e Planeve të nevojshme Hapësinore dhe Planeve Menaxhuese për Zonat e Mbrojtura të Natyrës.¹⁰⁵

Rekomandimet

1. Të vazhdohet/intensifikohet hulumtimi, evidentimi dhe monitorimi i zonave të natyrës dhe inventarizimi i llojeve bimore e shtazore dhe habitateve natyrore,
2. Të ndahet buxhet i dedikuar për investime kapitale në Parqet Kombëtare,
3. Të aprovohet Plani Hapësinor për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna", Plani Menaxhues për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe Planet Rregulluese për të gjitha zonat e mbrojtura që ende nuk kanë plane të tilla të nevojshme,
4. Të respektohet Zonimi i të 2 parqeve,
5. Të ngrihet buxheti dhe kapacitetet profesionale institucionale,
6. Të themelohen organe menaxhuese për zonat e mbrojtura dhe me interes të veçantë,
7. Të parandalohen prerjet e paligjshme përmes menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve sipas zonave mbrojtëse,

¹⁰⁵ [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_\(ok\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_(ok).pdf).


8. Të parandalohet gjuetia e paligjshme në ZM,
9. Të bëhet mbikëqyrja e rreptë e ndërtimeve bazuar në planin hapësinor dhe atë menaxhues,
10. Të ndalohet ndërtimi i hidrocentraleve brenda Parqeve Kombëtare,
11. Të bëhet parandalimi dhe monitorimi i zjarreve pyjore,
12. Të mbrohen/menaxhohen pellgjet lumore dhe të parandalohet ndotja e ujit,
13. Të ndërtohen impiante për trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave,
14. Të ndërmerren masa për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara të faunës sipas rekomandimeve dhe të gjeturave nga Librit të faunës së Kosovës,
15. Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore,
16. Të mbrohen habitatet e llojeve të rralla dhe të rrezikuara si dhe të përgatiten arsyetimet profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitateve sipas rrjetit ekologjik Natyra 2000,
17. Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda territorit të zonave të mbrojtura të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233),
18. Të bëhet inspektimi i vazhdueshëm nga Inspektorati i MMPHI në zonat e mbrojtura,
19. Të rritet numri i stafit në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.¹⁰⁶

Rekomandimet shtese te nevojshme për florën e faunën

1. Mbrojtja e tokës/ujit
2. Menaxhimi i tokës/ujit
3. Mbrojtja e burimeve dhe habitateve
4. Menaxhimi i llojeve,
5. Restaurimi i habitatit dhe procesit natyror,
6. Ripërtëritja e llojeve,
7. Rikthimi i llojeve,
8. Edukimi dhe vetëdijesimi,
9. Trajnimet adekuate,
10. Ligji dhe politikat,
11. Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit,
12. Stimulime rreth mjeteve të jetesës, ekonomike dhe të tjera,
13. Hulumentimi i vazhdueshëm (madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, historia e jetës dhe ekologjia),
14. Monitorimi (Trendet e popullatës, Trendet e habitatit)¹⁰⁷

¹⁰⁶ [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_\(ok\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB_(ok).pdf).


¹⁰⁷ [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_\(1\).pdf?fbclid=IwAR3EHo1OY7np6tRwRLwgEGlrEkXLPVXdLmucV7DxwOwfHK_VTxdtrOoa09o](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_(1).pdf?fbclid=IwAR3EHo1OY7np6tRwRLwgEGlrEkXLPVXdLmucV7DxwOwfHK_VTxdtrOoa09o)



pylltaria

Foto: Yllka Fetahaj

4. Pylltaria



Pasqyrë e përgjithshme

Mbështetur në Ligjin për Pyjet Nr. 2003/3, pyjet konsiderohen pasuri kombëtare me interes të përgjithshëm. Pyjet në mbarë botën kanë një interes shumë dimensional nisur nga fakti se përmbushin rol të rëndësishëm jetësor.¹⁰⁸ Bazuar në këtë, pyjet kanë rëndësi në përmbushjen e qëllimeve në aspektin ekologjik-mjedisor, ekonomik dhe social.

Kosova ka realizuar dy inventarizime nacionale të pyjeve, në vitin 2003 dhe 2013. Sipas inventarizimit të fundit, sipërfaqja pyjore në Kosovë është rreth 481,000 ha (44.7% e sipërfaqes totale),¹⁰⁹ çka konsiderohet si e qëndrueshme. Rreth 38% e sipërfaqes pyjore është në pronësi private, ndërsa 62% janë pyje publike. Sipërfaqet pyjore dominohen në masën 84% nga pyjet cungishte që menaxhohen me rotacion të shkurtër, kryesisht për prodhim të drurit për ngrohje. Pyjet e pastra fletore mbulojnë pothuajse 83% të sipërfaqes pyjore. Mbulueshmëria pyjore e Republikës së Kosovës është më e lartë se vendet fqinje (Shqipëria 28%, Maqedonia e Veriut 39%, Mali i Zi 40%, dhe Serbia 31%).

Vëllimi në këmbë i drurëve me diametër $> = 7$ cm në lartësi të gjoksit është 40.5 milion m^3 . Në mesin e drurëve, specie Fagus (ahu) kontribuojnë 46% të vëllimit, ndërsa speciet Quercus (dushqet) përfaqësojnë 23%. Mesatarja e vëllimit të drurëve në këmbë në Kosovë është 84 m^3/ha (mesatarja evropiane: 104 m^3/ha).

Rritja vjetore është llogaritur në 1.55 milion m^3 . Neto maksimumi i nivelit të prerjeve afatgjata për Kosovën është në nivelin prej 1.2 milion m^3 në vit. Ky vlerësim duhet të reduktohet më tej për shkak të sipërfaqeve të padisponueshme për furnizim me dru, duke marrë parasysh vëllimin brenda Parqeve Nacionale. Një analizë e kryer në rreth 60% të dokumenteve për sipërfaqet pyjore, evidenton se çdo vit kanë ndodhur prerje mesatare prej 950,000 m^3 . Rrjedhimisht, prerjet vjetore mund të vlerësohen në afërsisht 1.6 milion m^3 . Vetëm një pjesë e vogël e prerjeve (7%) është kryer në përputhje me legjislacionin pyjor.

Që nga fillimi i viteve të 90-ta e deri në vitin 2006, për shumicën e njësive menaxhuese nuk janë hartuar plane menaxhuese afatgjata. Pas vitit 2006, me përkrahje të donatorëve, ka filluar zhvillimi i planeve për menaxhimin e pyjeve (PMP), i cili ka vazhduar të jetë prioritet për qeverinë e Kosovës. Jo të gjitha njësitë menaxhuese pyjore (NjMP) kanë plane menaxhuese. Rreth 82% e pyjeve publike janë të mbuluara me plane menaxhuese. Aktualisht pyjet private nuk janë të mbuluara me plane adekuate menaxhuese. Madhësia mesatare e një pylli privat është rreth 1.4 ha.

108 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>.

109 https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/84090_Inventarizimi-Nacional-i-Pyjeve-Kosov%EB-2012_WEB.pdf.

Strategjia dhe Zbatimi

Bazuar në rëndësinë e dhe rolin e pyjeve, si dhe mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi si një nga objektivat kryesore të politikave të Bashkimit Evropian, dhe synimet e Kosovës për integrim, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020 në fillim të vitit 2010. Ndër politikat për intervenim dhe prioritetet e kësaj strategjie ishin: menaxhimi i pyjeve dhe silvikultura, planifikimi pyjor dhe menaxhimi i informacioneve, shfrytëzimi dhe transporti i drurit, ndërtimi i kapaciteteve, mbrojtja e mjediseve pyjore, shfrytëzimi dhe zhvillimi i industrisë pyjore, zhvillimi i sektorit privat dhe produktet pyjore jodrunore. Edhe pse niveli i zbatimit të strategjisë 2010-2020 nuk është vlerësuar zyrtarisht, përkundër zhvillimit të disa objektivave, është evidentuar progres i limituar në shumicën e objektivave dhe prioriteteve të saj.

Në vazhdim është hartuar Strategjia e re për Zhvillimin e Pylltarisë 2021-2030, e cila është aprovuar nga qeveria në dhjetor të vitit 2021.¹¹⁰ Në aspektin strategjik me politikat zhvillimore kombëtare dhe në harmoni me politika dhe strategji të tjera sektoriale të ndërlidhura, Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2022-2030 është përgatitur në përputhje me Strategjinë e BE-së për Pylltari 2020. Për të mbrojtur burimet pyjore të Kosovës dhe për të promovuar menaxhimin e tyre të qëndrueshëm, SZHP-ja 2022-2030 është strukturuar sipas kriterëve dhe qasjes të MQP-së të dakorduara nga *Forest Europe (Pyjet e Evropës)*. Ajo merr parasysh skenarin e ardhshëm politik dhe socio-ekonomik të Kosovës, si dhe gjenerimin e teorisë së ndryshimit, e cila përshkruan hapat dhe lidhjet e tyre që do të çojnë në rezultatin e planifikuar.

Strategjia i ka pesë objektiva strategjike:

1. Përmirësimi i gjendjes së resurseve pyjore,
2. Mbrojtja e resurseve pyjore,
3. Përdorimi i qëndrueshëm dhe shumë funksional i resurseve pyjore,
4. Zhvillimi i kapaciteteve të sektorit të pylltarisë,
5. Digjitalizimi dhe përmirësimi i komunikimit.

Legjislacioni dhe zbatimi

Pyjet e Kosovës menaxhohen në bazë të Ligjit për Pyjet Nr. 2003/3¹¹¹. Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, dhe në bazë të planit të Ahtisarit për decentralizim, ligji për pyjet ka pësuar plotësim ndryshime. Në bazë të këtyre ndryshimeve, kompetencat e menaxhimit të pyjeve janë të ndara në nivelin qendror dhe lokal. Departamenti i pyjeve në kuadër të MBPZHR-së është përgjegjës për hartimin e legjislacionit dhe politikave, ndërsa Agjencia Pyjore e Kosovës si institucion ekzekutiv, është përgjegjëse për zbatimin e menaxhimit të pyjeve, planifikimin dhe hartimin e planeve menaxhuese, trajtimin dhe monitorimin e shfrytëzimit të pyjeve. Në nivelin lokal, komunat janë përgjegjëse për

¹¹⁰ <https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41272>.

¹¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>.

mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve, tenderimin dhe dhënien e lejeve për prerje si dhe lejeve të transportit të masës drunore.

Ekzistojnë 45 akte nënligjore (udhëzime administrative) që lidhen me pylltarinë dhe gjuetinë dhe disa prej tyre janë ndryshuar dhe plotësuar një ose dy herë. Përveç Kushtetutës dhe Ligjit për Pyjet, janë rreth 13 ligje që ndërlidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me pyjet.

Gjithashtu është përgatitur Programi Kombëtar i Pyllëzimit dhe Ripyllëzimit i Kosovës (PKPR) 2018-2027 dhe Programit Kombëtar i Shëndetit të Pyjeve (PKSHP) 2018-2027. Objektivi e PKPR është promovimi i pylltarisë së qëndrueshme dhe funksioneve të saj ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke zbatuar skema dhe shërbime të cilat e stimulojnë zhvillimin rural. Programi kombëtar ende nuk ka filluar të zbatohet sipas objektivave dhe rekomandimeve.

Ligji i ri për pyjet është hartuar disa herë që nga viti 2013 dhe është proceduar në disa faza miratimit, por për shkak të ndryshimeve të shpeshta politike nuk ka arritur të miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas krijimit të institucioneve të reja në vitin 2021, ligji i ri për pyjet është rishqyrtuar në MBPZHR dhe është miratuar nga qeveria. Në kohën e hartimit të këtij raporti, ligji është në shqyrtim nga komisioni përkatës parlamentar dhe pritet procedimi në kuvend për miratim.¹¹²

Projektligji i ri për Pyjet është i ndarë në 13 kapituj dhe 79 nene dhe qëllimi i tij është krijimi i bazës ligjore për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe tokave pyjore si resurse me interes të përgjithshëm. Disa nga ndryshimet që janë paraparë në projektligjin e ri për pyjet janë edhe kompetencat e menaxhimit dhe mbrojtjes së pyjeve. Kompetencat e mbrojtjes së pyjeve kalojnë nga niveli komunal në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Pyjet brenda parqeve kombëtare parashihen të menaxhohen nga Agjencia Pyjore e Kosovës sipas zonave mbrojtëse.

Problemët kryesore

Prerjet e pakontrolluara vazhdojnë të jenë problem dhe sfida kryesore e sektorit të pylltarisë. Sipas vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare, kërkesa për dru zjarri (rreth 1.8 milion m³ në vit) e kalon rritjen vjetorë të masës drusore e cila është rreth 1.5 milion m³.

Në bazë të raportit të gjelbër 2021¹¹³ nga MBPZHR, vëllimi drusor në pyje shtetërore i planifikuar për shfrytëzim në vitin 2020 ishte 67,513 m³, ndërsa sasia e shfrytëzuar ishte vetëm 25,947 m³ (38.43% e planit). Planifikimi i shfrytëzimit të pyjeve private në vitin 2020 ishte 132,000m³. Në total, prerja vjetore e kontrolluar ishte rreth 200,000 m³ apo 11% e kërkesës së përgjithshme të vlerësuar prej 1.8 milion m³.

Ndër sfidat e tjera të sektorit janë kapacitetet e limituara të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Agjencia Pyjore e Kosovës ka staf të limituar profesional dhe teknik, ndërsa mjetet e punës dhe të terrenit janë po ashtu të limituara. Komunat të cilat

¹¹² https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperpyjet_dPCgz4Ywtr.pdf.

¹¹³ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_2021_.pdf.

janë përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve, po ashtu kanë staf të limituar të rojeve të pyllit, mesatarisht një rojtar mbulon mbi 2000 ha pyje.

Problem tjetër mbetet niveli i ulët i bashkëpunimit dhe koordinimit mes institucioneve përgjegjëse, si MBPZHR, MMPHI dhe komunave. Parqet kombëtare, si bartëse kryesore të rritjes vjetore dhe vëllimit të përgjithshëm të masës drusore, nuk shfrytëzohen sipas kritereve të zonimit. Sfiduese mbeten edhe kapacitetet e kufizuara menaxhuese profesionale dhe në numër të të punësuarve. Në të dyja parqet kombëtare nuk është i punësuar asnjë inxhinier i pylltarisë. Stafi i përgjithshëm në të dy parqet kombëtare është 30 punëtorë, kurse sipas vlerësimeve numri i të punësuarve duhet të jetë rreth 150.

Disa nga problemet tjera:

- Zbatimi i pamjaftueshëm i akteve ligjore dhe nënligjore, strategjive dhe programeve,
- Investime dhe ndarje buxhetore të pamjaftueshme dhe jo prioritare për sektorin e pylltarisë,
- Mungesa e shkollës së mesme profesionale dhe mungesa e investimeve për ngritje të kapaciteteve.

Kapacitetet institucionale

Në bazë të ligjit për pyjet, Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) në kuadër të MBPZHR-së është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore publike dhe kontrollimin e menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore private, përfshirë grumbullimin e produkteve pyjore jodrunore. Bazuar në Ligjin për Gjuetinë, APK-ja është gjithashtu pjesërisht përgjegjëse për gjuetinë dhe menaxhimin e kafshëve të egra. Departamenti i Pylltarisë në kuadër të MBPZHR-së është përgjegjës për politikën dhe strategjitë e sektorit të pylltarisë. MMPHI-ja, nëpërmjet Drejtorisë së Parkut Kombëtar "Sharri" dhe Drejtorisë së Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", është përgjegjëse për menaxhimin e dy parqeve kombëtare në Kosovë. Ato gjithashtu mbledhin në mënyrë sporadike informata mbi biodiversitetin dhe ekosistemin në terren. Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit është përgjegjës për inspektimin e mbrojtjes së natyrës, ndërsa Inspektorati i Pylltarisë dhe Gjuetisë në kuadër të APK-së monitoron menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, menaxhimin e kafshëve të egra dhe grumbullimin e produkteve pyjore jodrunore.

Sipas raportit të Ministrisë së Financave, numri i përgjithshëm i personelit që punon në sektorin e pylltarisë është 162 punëtorë (155 në APK dhe 7 në DP në kuadër të MBPZHR-së), ndërsa numri i personelit që punon në nivel komunal është 194 punëtorë. Disa komunave u mungon stafi në këtë sektor.

Komunat kanë kapacitete të kufizuara të stafit të pylltarisë (4 inxhinierë, 35 teknikë, 205 roje pyjore). Pagat dekurajuese, kushtet e papërshtatshme të punës, si dhe mungesa e pajisjeve dhe automjeteve, janë ndër problemet që pengojnë aktivitetet pyjore në terren.

Përkufizimi ligjor i pyjeve si një resurs kombëtar me interes të përgjithshëm dikton bashkëpunimin dhe koordinimin e shumë palëve të interesit, institucioneve të qeverisë qendrore dhe atyre komunale, si dhe shoqatave joqeveritare.

Palët kryesore të interesit nga Institucionet Qeveritare dhe Joqeveritare janë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);
- Agjencia Pyjore e Kosovës (APK);
- Departamenti i Pylltarisë (DP);
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI);
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT);
- Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP);
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT);
- Komunat;
- Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK);
- Asociacioni Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Private (AKPPP);
- Oda Ekonomike e Kosovës (OEK).

Investimet

Megjithëse pyjet e Kosovës përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të potencialit ekonomik, praktikat aktuale nuk sigurojnë të hyra të rëndësishme për ekonominë e vendit. Zbatimi i dobët i ligjit dhe qeverisja joefektive dhe joefikase çojnë në humbje të rendimentit ekonomik, që përndryshe do të kontribuonte në ekonominë lokale dhe do të përmirësonte jetesën e qëndrueshme.

Në bazë të studimeve dhe raporteve të shpërndara prej projekteve të ndryshëm, mund të arrihet në përfundimin si në vijim:

Pylltaria në Kosovë aktualisht punëson vetëm afro 2% të gjithsej fuqisë punëtore.¹¹⁴ Punësimi formal dhe joformal në operacionet e shfrytëzimit të pyjeve sillet ndërmjet 2500-3000 vende pune. Institucionet qeveritare që ndërlidhen me pyjet punësojnë 288 persona, prej të cilëve 48 janë gra. Industria e përpunimit të drurit kontribuon në punësim me një përqindje më të lartë. Në Kosovë janë 1,778 biznese të produkteve të drurit dhe mobilieri, të cilat kryesisht janë ndërmarrje mikro me më pak se 10 të punësuar. Gjithsej të punësuarit në industrinë e drurit, vlerësohen të jenë rreth 5000-6000 punonjës.

Numri i grumbulluesve të produkteve pyjore jodrunore (PPJD) llogaritet të jetë ndërmjet 11,400-20,000 me rreth 100 kultivues, 30-40 qendra grumbulluese dhe 10 kompani përpunuese.

Kontributi i pylltarisë në BPV është rreth 1% dhe vlera e prodhimit të lëndës drunore sillet ndërmjet 24-48 milionë euro, ndërsa nga industria e përpunimit final të drurit ndërmjet 40-50 milionë euro. Nuk ka të dhëna zyrtare për PPJD-të.

Eksporti i produkteve drunore ishte gjithsej 28.6 milionë euro më 2019 (kryesisht nga sektori i mobilierisë, që përfaqëson 7.5% të gjithsej eksportit. Eksporti i PPJD-ve llogaritet të jetë rreth 16.6 milionë euro. Raporti eksport-import është 1:7, krahasuar me 1:29 në vitin 2012.

¹¹⁴ <https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41272>.

Ndarja buxhetore dhe investimet kapitale për sektorin e pylltarisë nuk kanë qenë prioritet për institucionet vendore. Gjithsej buxheti vjetor i ndarë për sektorin e pylltarisë në 5 vitet e fundit ka qenë rreth 2.2 milionë euro/vit nga rreth 60 milionë euro nga buxheti i përgjithshëm i MBPZHR-së. Të hyrat nga sektori i pylltarisë kanë shënuar rritje të lehtë në periudhën e njëjtë, duke arritur në 1.9 milionë euro në vitin 2019, që është më e lartë se gjithsej shpenzimet prej 0.5 milion eurosh.

Rekomandimet

1. Të fillojë zbatimi i objektivave të Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë,
2. Të miratohet ligji në Kuvendin e Republikës së Kosovës,
3. Të rriten buxheti dhe investimet kapitale në pylltari,
4. Të përmirësohet planifikimi i prerjeve ligjore dhe plotësimi i nevojave për furnizim me lëndë drusore,
5. Të përmirësohen kapacitetet ekzistuese si dhe ofrohen bursa për studentët të cilët dëshirojnë të studiojnë në fushën e pylltarisë,
6. Të rritet eficientia e energjisë që ndikon në uljen e kërkesës për lëndë drusore për ngrohje,
7. Të promovohet shfrytëzimi i biomasës drusore si energji e ripërtërishme, të përdoren mbetjet drusore dhe të bëhet pastrimi i pyjeve,
8. Të përkrahen pronarët e pyjeve private përmes skemave të pagesave direkte dhe granteve investive,
9. Të krijohet fondi për shërbimet e ekosistemeve pyjore,
10. Të zbatohet shfrytëzimi i pyjeve në parqe kombëtare sipas zonave të mbrojtjes duke ushtruar kontroll rigoroz të prerjes.

Koha të veprimë!



ndryshimet klimatike

Foto: Yllka Fetahaj

5. Ndryshimet Klimatike



Pasqyrë e përgjithshme

Sipas studimeve shkencore, aktiviteti njerëzor është duke ndikuar në ndryshimin e klimës në tokë si rezultat i prodhimit të gazrave serë, të cilat në masë të madhe shkaktohen nga prodhimi i energjisë me lëndë djegëse fosile, prerja e pyjeve, bujqësia, feramat dhe prodhimi i kimikateve. Shtimi i efektit të gazrave serë në atmosferë është duke shkaktuar rritje të temperaturës së tokës, e cila më pas sjell edhe ndryshimet klimatike. Sipas studimeve shkencore, nëse nuk ndërmerren masa tani, pasojat do të jenë të mëdha, duke përfshirë: vdekjet e parakohshme për shkak të ndotjes së ajrit, vapës, mungesës së ujit, si dhe humbjet ekonomike.

Kosova nuk është nënshkruese e marrëveshjes së Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe Marrëveshjes së Parisit, por meqenëse aspiron anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA), ajo obligohet që të zbatojë politikat që dalin nga kapitulli 27 dhe që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Duke u nisur nga fakti se Kosova është shtet i ri, i cili ballafaqohet ende me probleme elementare që lidhen me zhvillimin e ekonomisë, shëndetësinë dhe sundimin e ligjit, ajo ende nuk ka arritur që t'i kushtojë vëmendje sa duhet mbrojtjes së mjedisit apo ta cilësojë atë si prioritet në programin e saj qeveritar.

Hapat që ka ndërmarrë deri më tani, janë ende fillestarë dhe tejet minorë krahasuar me kriteret e BE-së dhe nevojat e vendit. Sa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit në ndryshimet klimatike, Kosova tani gjendet në udhëkryq, sepse ende i mungon strategjia kombëtare për energjinë. Duke mos pasur njohuri nëse Kosova do ta vazhdojë edhe më tej prodhimin e energjisë me thëngjill, që njëkohësisht është një prej prodhuesve kryesor të gazrave serë që kanë efekt të madh në ndryshimet klimatike, atëherë nuk mund të garantohet se Kosova do të mundet të ndërmarrë veprime të drejta dhe të qëndrueshme që do të kishin efekt pozitiv në këtë drejtim.

Në anën tjetër, duhet përmendur se viteve të fundit janë vërejtur edhe disa hapa pozitivë në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Në programin e Qeverisë 2021-2025, kapitulli për Mjedisin dhe Planifikimin hapësinor, parashikohet hartimi i strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe për mbrojtje të mjedisit. Në kuadër të këtij programi, është parapare miratimi i një serie të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, duke përfshirë këtu edhe ligjin për ndryshimet klimatike dhe inventarin e emetimit të gazrave serë.

Ndërkaq, nënshkrimi i MSA-së në vitin 2015 dhe Agjendës së Gjelbër në vitin 2020, janë dy iniciativa të rëndësishme me të cilat edhe Kosova dëshiron që të dëshmojë se është zotuar të japë kontributin e saj për mbrojtjen e mjedisit.

Në kuadër të MSA-së, neni 116, tek pjesa e ndryshimeve klimatike, nga Kosova pritet që t'i adresojë shqetësimet klimatike, ta përafrojë legjislacionin me acquis të BE-së dhe të ndërmarrë masa për monitorimin dhe uljen e emetimeve të gazrave serë, e që lidhen me

fushën e energjisë, transportit, industrisë dhe bujqësisë. Me këto veprime, Kosova do të mund t'i bashkëngjitet edhe përpjekjeve globale që kontribuojnë në fushën e ndryshimeve klimatike.

Strategjia dhe plani

Për të reaguar ndaj ndryshimeve klimatike, në vitin 2020, Komisioni Evropian ka aprovuar "Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane", e cila është mjaft ambicioze, sepse parashikon që shtetet e Bashkimit Evropian të ndërmarrin iniciativa që do t'i bëjnë neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050. Plan i synuar për klimën 2030 ka paraparë tri objektiva kryesore (Komisioni Evropian):

- Përcaktimin e objektivave më ambiciozë dhe me kosto efektive për të arritur neutralitetin ndaj klimës deri më 2050,
- Stimulimin e krijimit të vendeve të gjelbra të punës dhe vazhdimin e punës për të evidentuar zvogëlimin e gazrave serë edhe gjatë rritjes ekonomike,
- Inkurajimin e partnerëve ndërkombëtarë për të rritur ambiciet për të kufizuar rritjen e temperaturës globale në 1.5°C dhe mënjanuar pasojat e ndryshimeve klimatike.¹¹⁵

Sa u përket dokumenteve strategjike me efekt në fushën e ndryshimeve klimatike, në vitin 2019 Qeveria ka miratuar strategjinë dhe planin e veprimit për ndryshime klimatike për periudhën 2019-2021, si dhe koncept dokumentin e rëndësishëm (21.12.2020) që do të çojë drejt përgatitjes së ligjit për ndryshimet klimatike. Në anën tjetër, janë formuar edhe grupet ndërministrare që janë duke punuar për planin kombëtar për energji dhe klimë.

Si objektivi i parë strategjik në fushën e ndryshimeve klimatike është paraparë: Zhvillimi i kapaciteteve për përmbushjen e obligimeve për të ardhshmen në kuadër të Konventës UNFCCC dhe BE-së.

Strategjia përmban edhe katër objektiva të tjera strategjike, të cilat synojnë:

- Zvogëlimin e emetimeve të gazrave serë;
- Zhvillimin e mekanizmave të rinj dhe përmirësimin e atyre aktualë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në sektorët me rëndësi ekonomike që janë të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike;
- Ngritjen e kapaciteteve për përshtatje të sistemeve natyrore;
- Ngritjen e kapaciteteve të partnerëve, akterëve dhe hisedarëve qendrorë dhe lokalë për integrimin në proceset zhvillimore të çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes ndaj tyre.

Ndërkaq, në kuadër të planit të veprimit janë paraparë aktivitete që kërkojnë përgatitjen e disa dokumenteve të rëndësishme, siç janë:

- Hartimi i koncept dokumentit për ndryshimet Klimatike;

¹¹⁵ Komisioni Evropian, Ligji Evropian për Klimën, qasur më 2 maj, 2022, https://ec.europa.eu/clima/eu-action/european-green-deal/european-climate-law_en.

- Hartimi i UA për kapjen e dioksidit të karbonit;
- Zhvillimi i sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit të gazrave serë në përputhje me Rregulloren e BE, Nr. 525/2013 nenet 5, 7, 12 për mekanizmin monitorues dhe raportimin 2019-2021;
- Rishikimi i Udhëzimit Administrativ QRK Nr. 01/2016 për mekanizmin e përcjelljes së emetimeve të gazrave serë¹¹⁶

Ndërsa, në qoftë se analizohen afatet kohore për zbatimin masave të parapara në strategji, atëherë mund të thuhet se ka ende ngecje në zbatimin e disa masave. Sipas përgjigjeve zyrtare të MMPH-së të dërguara në maj 2022, janë disa dokumente strategjike për të cilat Qeveria është duke punuar, e që janë:

- Strategjia Afatgjate për Dekarbonizim - e cila ka filluar të hartohet në fillim të këtij viti. Gjithashtu është formuar grupi punues ndërministror dhe është mbajtur takimi i parë i grupit.
- Është hartuar edhe Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë - Plani është në përfundim e sipër dhe pritet miratimi i Strategjisë për Energji me qëllim të harmonizimit të këtyre dy dokumenteve.
- Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike - ky dokument do të hartohet në vitin 2023, pasi që Plani ekzistues ka mbuluar periudhën 2019-2021, duke e lënë vitin 2022 pa asnjë masë që duhet ndërmarrë.

Legjislacioni dhe zbatimi

Komisioni Evropian ka propozuar Ligjin Evropian për Klimën (29 korrik 2021) që përcakton caqe të reja për uljen për 55% të nivelit të emetimeve të gazrave serë deri më 2030, krahasuar me nivelet e vitit 1990. Për ta zbatuar këtë ligj do të duhej të bëheshin reforma në sektorët energjetik, industrial, të transportit, fermave, bujqësor etj.

Objektivat e këtij ligji (Ligji Evropian për Klimën)¹¹⁷ janë:

- *"Të përcaktojë drejtimin afatgjatë për të arritur objektiven e neutralitetit ndaj klimës deri më 2050, përmes të gjitha politikave në mënyrë sociale dhe me kosto efektive,*
- *Të përcaktojë caqe më ambicioze të BE-së, për ta bërë Evropën më përgjegjëse drejt rrugës neutrale ndaj klimës deri më 2050,*
- *Të krijojë sistem për monitorimin e progresit dhe të ndërmerren masa nëse është e nevojshme,*
- *Të ofrojë parashikim për investitorët dhe akterët e tjerë ekonomikë,*
- *Të sigurojë që tranzicioni i neutralitetit ndaj klimës të jetë i pakthyeshem".*

Në kuadër të këtij ligji, janë paraparë masa për të cilat duhet të dëshmohet progresi, e që do të reflektohen në proceset qeverisëse për shtetet anëtare të BE-se, planet kombëtare për

116 MMPH, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028. Republika e Kosovës, Prishtinë, 2018, 7. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29356>.

117 Komisioni Evropian, Ligji Evropian për Klimën, qasur më 2 maj, 2022, https://ec.europa.eu/clima/eu-action/european-green-deal/european-climate-law_en.

energjinë dhe klimën, raportet e rregullta nga Agjencitë Evropiane të Mjedisit, si dhe në evidencën shkencore më të fundit për ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre.

Për me tepër, Rregullat për qeverisje të unionit për energji dhe veprime klimatike, kanë paraparë që të ketë Plane Kombëtare për Energji dhe Klimë (PKEP) përmes të cilave do të adresoheshin eficienta e energjisë, energjia e ripërtërishme, reduktimi i emetimeve të gazrave serë, interkoneksionet, hulumtimet dhe inovacionet.

Kosovës ende i mungon ligji për ndryshime klimatike, i cili është në proces të hartimit. Në të njëjtën kohë ky është një prej ligjeve kryesore që do të mund të japë rezultate konkrete në fushën e ndryshimeve klimatike (përgjigja nga MMPH-ja, maj 2022).

Aktualisht Kosova ka kornizë ligjore që përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- UA për substancat që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serë të fluoruara;
- UA për qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emetimin e CO₂ të automjeteve të reja personale;
- UA për zbatimin e mekanizmave fleksibël për zhvillim të pastër;
- UA për mekanizmin e përcjelljes së emetimeve të gazrave serë;
- UA për përcjelljen e emetimeve të gazrave serë;
- UA për kapjen dhe depozitimin e CO₂ në formacione të përshtatshme gjeologjike.

Është e rëndësishme të theksohet se këto akte normative kanë transpozuar aktet të acquis të BE-së si në vijim:

- Direktiva Nr. 1999/94/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 1999 në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO₂ në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve;
- Direktiva Nr. 2003/87/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 2003 që krijon një skemë për tregtimin e lejimit të emetimeve të gazrave serë brenda Komunitetit dhe amendon Direktivën e Këshillit 96/61/EC;
- Direktiva Nr. 2004/101/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 tetor 2004 që ndryshon Direktivën 2003/87/EC që krijon një skemë për tregtimin e lejimit të emetimeve të gazrave serë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e projektit të Protokollit të Kiotos;
- Direktiva Nr. 2009/29/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 23 prillit 2009 amendimi i Direktivës 2003/87/EC në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë lejimin e emetimit të gazrave serë skema tregtare e Komunitetit;
- Direktiva Nr. 2009/31/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Prill 2009 për ruajtjen gjeologjike të dioksidit të karbonit dhe ndryshimin e Direktivës së Këshillit 85/337/EEC, Direktivave të Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2000/60/EC, 2001/80/EC, 2004/35/EC, 2006/12/EC, 2008/1/EC dhe Rregullorja (EC) Nr. 1013/2006;
- Rregullorja (KE) Nr. 219/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2009 që përshtat një serë instrumentesh që i nënshtrohen procedurës së përmendur në nenin 251 të Traktatit të Vendimit të Këshillit 1999/468/KE në lidhje me

rregullatorë e procedura me shqyrtim - Përshatja me procedurën rregullatore me shqyrtim;

- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 291/2011 e datës 24 mars 2011 mbi përdorimet thelbësore të substancave të kontrolluara të ndryshme nga hidroklorofluorokarburet për qëllime laboratorike dhe analitike në Bashkim sipas Rregullores (KE) Nr. 1005/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit;
- Rregullorja Nr. 525/2013/KE e Mekanizmit për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazrave serë dhe për raportimin e informacioneve të tjera në nivel kombëtar dhe të Bashkimit lidhur me ndryshimet klimatike;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 744/2010 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 1005/2009 mbi substancat që varfërojnë shtresën e ozonit, në lidhje me përdorimet kritike të haloneve; Rregullorja (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 maj 2006 mbi disa gazra serë të fluorizuara;
- Rregullorja Nr. 1005/2009/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit më 16 shtator 2009 mbi substancat që shterojnë shtresën e ozonit;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1493/2007 e datës 17 dhjetor 2007 që përcakton formatin e raportit që duhet të dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e gazrave të caktuara serë të fluorizuara;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1494/2007 e datës 17 dhjetor 2007 që përcakton, në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 842/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, formën e etiketave dhe kërkesat shtesë të etiketimit në lidhje me produktet dhe pajisjet që përmbajnë disa gazra serë të fluorizuara;
- Rregullorja Nr. 1516/2007/KE e datës 19 dhjetor 2007 që përcakton, në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 842/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, kërkesat standarde të kontrollit të 122 rrjedhjeve për pajisjet e ftohjes stacionare, klimatizimin dhe pompën e nxehtësisë që përmbajnë disa gazrat serë të fluorizuar.

Për të lehtësuar zbatimin e MSA-së, Kosova ka përpiluar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA). Në kuadër të PKZMSA-së, tek kapitulli 27 flitet për Mjedisin dhe ndryshimet klimatike, si dhe për masat që duhet të ndërmerren. Në këtë plan janë përfshirë gjithsej 14 masa, ku 8 prej tyre kanë të bëjnë me legjislacionin dhe 6 masa të tjera janë masa zbatuese. Analiza e këtij dokumenti tregon se ka ngecje në këtë drejtim, sepse nga 14 masat e parapara janë zbatuar vetëm 7 masa.¹¹⁸

Masat të cilat nuk janë zbatuar janë:

- Miratimi i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për ujërat e Kosovës (plotësim-ndryshim);
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për pyjet (plotësim-ndryshim);
- Miratimi i UA Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin uJOR (plotësim-ndryshim);

118 Raport mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) gjatë vitit 2021, 38, <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/10/1-PKZMSA-2021-2025-miratuar-nga-Kuvendi.pdf>.

- Miratimi i koncept dokumentit për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit;
- Përfundimi i studimit të fizibilitetit për deponinë e Mirashit në Obiliq;
- Përfundimi i studimit të vlerësimit të sigurisë së digave ekzistuese.

Ndërsa, sa i përket zbatimit të Agjendës së Gjellbër, me përjashtim të monitorimit që është bërë nga organizatat e shoqërisë civile, në këtë fazë nuk ekziston ndonjë dokument që mund të vërtetojë zbatimin e masave të planifikuara në kuadër të saj.

Problemet kryesore

Në bazë të raportit të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit për vitin 2019, shkaktar kryesor i emetimeve të gazrave serë në Kosovë është sektori i energjisë, i cili kontribuon me 86 %, pastaj sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimi i tokës, që rezulton me 8%, sektori i mbeturinave me 5%, dhe proceset industriale me 1%.¹¹⁹

Duke marrë për bazë të dhënat e emetimeve të gazrave serë ndër vite, atëherë vërehet se nga viti 2014 deri në vitin 2018 Kosova ka pasur rritje graduale vjetore, duke filluar me 216 Gg CO₂ eq. deri në 250 Gg CO₂ eq, me një ulje të vogël në vitin 2019, e cila rezulton me 235Gg CO₂ eq.

Sa i përket emetimeve të CO₂ (ton eq) për koke banori, krahasuar me disa vende botërore të zhvilluara, Kosova qëndron më mirë, pra me 5 ton CO₂/banor, krahasuar me SHBA (15 ton CO₂/banor), Gjermaninë (8.8 ton CO₂/banor) dhe Mbretërinë e Bashkuar (5.8 ton CO₂). Arsyeja pse ndodh kjo mund të shpjegohet me zhvillimin e madh industrial që kanë këto vende, që Kosova nuk e posedon. Mirëpo, nëse krahasohet me rajonin, atëherë Kosova nuk qëndron edhe aq mirë, ku me përjashtim të Bosnjë e Hercegovinës (6.5 ton CO₂) dhe Serbisë (6.4 ton CO₂), të gjitha vendet e tjera shënojnë vlera më të ulëta.

Për më tepër, në qoftë se analizohet gjendja e mjedisit për dy dekada me radhe, atëherë lirisht mund të thuhet se Kosova ka ngecje të theksuara në mbrojtje të mjedisit dhe zbatim të masave që do të kishin impakt pozitiv në ndryshimet klimatike. Kjo vjen si rezultat i mungesës së vetëdijes së politikëbërësve për kërcënimet reale në ndryshimet klimatike, mungesës së vullnetit politik, kapacitetit njerëzor dhe atij financiar. Gjithashtu, zhvillimi i hovshëm ekonomik, i shoqëruar me ndërtime të pakontrolluara, pa zbatim të kriterëve për mbrojtje të mjedisit, mungesa e sundimit të ligjit dhe korrupsioni, janë shkaktaret kryesor për degradim enorm të mjedisit me ndikim në ndryshimet klimatike. Po që se nuk reagohet tani, gjendja vetëm sa do të përkeqësohet, duke lënë pasoja afatgjata dhe gati të riparueshme për gjeneratat e ardhshme. Për më tepër, disa prej masave që kanë ndikim pozitiv në reduktimin e emetimeve të gazrave serë mund të ndërmerren edhe nga niveli komunal, duke përfshirë: investimet në energji eficiente, ngrohje qendrore, menaxhim të mbeturinave dhe deponive, si dhe plane të mobilitetit për transport. Fatkeqësisht, mungesa e vetëdijes së politikëbërësve vërehet edhe në nivelin komunal ku, me përjashtim të

119 Raporti i Emetimit të Gazrave Serë në Kosovë 2014-2019, 7, [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Raporti_GHG_2014-2019_\(final_ueb_version\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Raporti_GHG_2014-2019_(final_ueb_version).pdf).

Komunës së Prishtinës dhe Gjakovës të cilat kanë bërë investime në ngrohjen qendrore, asnjë komunë tjetër nuk ka ndërmarrë iniciativa të cilat do të qonin drejtë uljes së emetimeve të gazrave serë.

Kapacitetet Institucionale

Përgjegjës kryesor për Sistemin Kombëtar të Inventarit të Gazrave Serë është Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), në kuadër të së cilit vepron edhe grupi i ekspertëve për sektorë të ndryshëm. Gjithashtu, AMMK është përgjegjës për raportimin dhe publikimin e të dhënave të inventarit. Rëndësia e inventarit lidhet me identifikimin e prejardhjes së emetimeve, përmes të cilit mund të krijohen politika dhe masa të duhura të cilat do të ndihmonin në kontrollin dhe uljen e emetimeve të gazrave serë.

Edhe pse AMMK-ja e përgatit për çdo vit inventarin e gazrave serë duke u bazuar në manualin e IPCC 2006, në raportin e saj të dhënat nuk publikuar në mënyrë të rregullt. Në bazë të evidencës, këto të dhëna janë publikuar vetëm dy herë, për vitet 2008-2013 dhe vitet 2014-2019. Ndërkaq, në qoftë se Kosova anëtarësohet në UNFCCC, atëherë ajo do të jetë e obliguar që t'i raportojë çdo vit.

Sa i përket kapacitetit institucional për të ndikuar në ndryshimet klimatike, Kosova vetëm sa ka nisur punën në këtë drejtim, dhe ka ende nevojë që t'i ndërtojë kapacitetet e saja, sidomos për monitorimin e zbatimit të planeve dhe ligjeve që lidhen me këtë fushë. Sipas përgjigjeve zyrtare të AMMK-së (qershor, 2022), sfidë mbetet mungesa e krijimit të një sektori të veçantë për ta kryer këtë aktivitet dhe largimi i stafit të trajnuar. Ata gjithashtu theksojnë se kanë nevojë që të forcohen kapacitetet e tyre për monitorimin e gazrave serë. Në anën tjetër, së fundmi vërehen edhe disa iniciativa dhe projekte nga donatorët e huaj që kanë filluar të japin ndihmë në këtë drejtim.

Investimet

Kostoja për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të parapara në planin e strategjisë për ndryshimet klimatike për vitet 2019-2021 është 2,877,600.00 EURO. Ndërkaq, sa i përket buxhetit për vitet në vijim, nuk dihet vlera, sepse MMPH-ja është ende në proces të përgatitjes së planit.

Sa i përket investimeve në projekte që kanë ndikim në uljen e emetimeve të gazrave serë, Ministria e Ekonomisë ka planifikuar investime në kuadër të Projektit për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtërishme, të cilat ndahen në dy komponentë:¹²⁰

1. Investimi në eficiencë të energjisë dhe energji të ripërtërishme në ndërtesa publike (29.56 milionë USD)
2. Përkrahje për politikën dhe kornizën rregullatore për ER/EE (2.30 milionë USD)

Ky projekt është përkrahur nga Banka Botërore përmes kredisë IDA, me një shumë totale prej 31 milionë USD.

120 Ministria e Ekonomisë, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtërishme, 15 maj, 2022.

-Rekomandimet

1. Të miratohet Strategjia e Energjisë, e cila duhet të jetë në linjë me strategjinë dhe planin për ndryshimet klimatike;
2. Të miratohet Ligji për Ndryshimet Klimatike, duke marrë për bazë kërkesat e BE-së për ndryshimet klimatike;
3. Të krijohet një njësi e veçantë në kuadër të AMMK-së, e cila do të merrej me përgatitjen e inventarit, punësimin e stafit përkatës dhe trajnimin e tyre. Meqenëse ligji për ndryshime klimatike është në proces të hartimit, duhet të shfrytëzohet kjo mundësi për krijimin e njësisë së veçantë .
4. Të ofrohen trajnime dhe teknologjia e nevojshme për stafin i cili do të merret me inventarin e emetimeve të gazrave serë.
5. Të ngrihen kapacitetet e MMPH për monitorimin e zbatimit të planeve dhe ligjeve që lidhen me ndryshimet klimatike.
6. Të rriten investimet qeveritare në projekte të cilat do të çonin drejtë uljes së emetimeve të gazrave serë (krijimi energjisë përmes burimeve të ripërtërishme, investimet në efikasitet të energjisë, përgatitja e planeve të mobilitetit për transport që synojnë reduktimin e CO₂, përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave dhe deponive, përmirësimi i menaxhimit të pyjeve, shtimi i hapësirave të gjelbra, e vetëdijesimi i publikut për të zvogëluar konsumin masiv, ricikluar dhe ripërdor materialet e ndryshme).
7. Të sigurohen fonde dhe të hartohen projekte komunale për të investuar në masa të cilat do të kenë efekt pozitiv në ndryshimet klimatike (efikasitet të energjisë, ngrohje qendrore, përmirësim të menaxhimit të mbeturinave dhe deponive, plane të mobilitetit për transport).
8. Të organizohen fushata vetëdijesuese për qytetarë lidhur me ndryshimet klimatike dhe menaxhimin e tyre.

Koha të veprojmë!



KOALICION27